



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIV i botimit, nr. 150, PRILL 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

"DUKAGJINI" - 150 2

Kjo gazetë filloj dhe vazhdon të jetë një dritare për të parë më tej, një dritë jo e vogël në rrugën e mjegulluar të kohës, veçanërisht për krahinën e Dukagjinit, në të kaluarën, por, edhe drejt së ardhmes, një dritare nga mund të shikohet në brendësi të Dukagjinit dhe dukagjinave, në shpirtin e tyre, në zemrën e tyre

SHOSHJANËI E BREGUT TË BUNËS 3

Në fshatin Shirq të Komunës Dajç Bregu i Bunës jetojnë një lagje me 40 shtëpi me origjinë nga fshati Palaj i Shoshit. Sipas pemës gjeologjike i pari këtij fisi ishte Kin Hila i vllaznisë Gjineshaj i larguar nga fshati mëmë i Palajve të Shoshit për arsye e hasmërie. Kinin e vogël babai e la jetim dhe në gjak. Nëna për të shpëtuar jetën e djalit të saj e la vatanin e baballarëve të djalit si tokë në gjak dhe iku e u vendos në Shirq të Bregut të Bunës. Sipas traditës Kinë Hila sa po mbushi 14 vjet, vrau katër asqer turq dhe morri arratinë në dhera të tjera jashtë Shqipërie për t'i shpëtuar ndëshkimit otoman.

MIRASH BINOSHI, RREZATONIE KULTURE DHE MRËSI 7

Duke u kthyer mbrapa në kohë dhe kujton ata që vite më parë janë larguar prej nesh, por që kujtimet e tyre duket sikur i kemi pranë. Kjo të kujton malet që të duken më qartë kur je në distncësi prej tyre, të duken më mirë madhështia dhe bukuritë e tij natyrore sa që të shtojnë dëshirën për ta parë. Kështu ngjan me ata që janë ndarë nga ne, siç është rasti i shokut dhe mikut tonë Mirash Binoshi. Ai është lindur në fshatin Lotaj të Shalës, në vitin 1933, në një familje fisnike tradicionalisht.

Detyra e tij ishte sa ushtarake aq edhe publike civile, të cilat i kreu me nder e dinjitet. Detyra e tij kishte të bënte me popullin sepse në atë kohë ne ishim popull-ushtar me shumë struktura të mirëorganizuar. Në këtë drejtim rol parësor luante dega ushtarake, në organizimin dhe plotësimin e organikave dhe ndjekjen e tyre në terren. Mirash Binoshi qe shembull në plotësimin...



Ç'është Dita e Verës? 6

Kadare në dritën e një "qyteti..."

NË NDERIM TË 80-VJETORIT TË LINDJËS SË ISMAIL KADARËSË

Duke shtegtuar në të parin roman të Kadaresë "Qyteti pa reklama" gjendesh përpara një befasie tepër të këndëshme: Mes nesh, për herë të parë, i plotë, në realitetin shqiptar të "republikës së letrave shqipe", i pari roman i Kadaresë "Qyteti pa reklama", pas një izolimi dhe "imigrimi" disjunktiv kadash në kushtet e realsocializmit dhe soçrealizmit shqiptar për t'u bërë, tashmë, pjesë e shëndetshëm të universitetit kadarejan, në mijëvjeçarin e ri. 10

FOLKU BASHKON HAPËSIRAT SHQIPTARE, NË ULQIN 8

ARTI, PËRKATËSISHT KULTURA BËN INTEGRIMIN SHPIRTËROR TË KOMBIT TONË

Para pak ditësh në qytetin e lashtë të Ulqinit, në shtëpinë e traditës, në një festë mbarshqiptare, Shoqëria Artistike "Tradita" vendosi të festojë, të gjithë së bashku, me koncertin "Premierë", me rastin e 3 vjetorit të themelimit të saj, aktivitet që u zhvillua në qendrën kulturore të qytetit. Spektakli i dhuruar nga artistët në skenë dhe pritja e ngrohtë e publikut, e sfiduan atë natë të ftohtë shkurti, sepse këngët dhe vallet sollën pranverën e këngëve dhe valleve shqiptare.

Në këtë festë të madhe që ngjasonte si një festival, me pjesëmarrjen e katër ansambleve folklorike nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, të cilët u bënë bashkë në një mbrëmje të madhe folklorike. Në sallën e tejmbushur e të mrekullueshme ishin vallet që na vinin plot freski...

“DUKAGJINI” - 150

Që në themelimin e Shoqatës “Atdhetare Dukagjini”, në kryesinë e saj, u shtrua çështja e daljes së një gazete ku të pasqyrohej puna e shoqatës, kryesisë së saj, veprimtarive, por edhe të vlerave historike, kulturore, etnografike, natyrore, por edhe të shtrojë mendime dhe bëjë analiza mbi veprimtarinë e përditshme të kohës, integrimin e komunitetit dukagjinas në vendbanimet e reja. Me gjithë vështirësitë e kohës, teknike, financiare, e të tjera, kjo gazetë filloj rrugën e saj në dhjetorin e vitit 2003.

Kjo gazetë filloj dhe vazhdon të jetë një dritare për të parë më tej, një dritë jo e vogël në rrugën e mjegulluar të kohës, veçanërisht për krahinën e Dukagjinit, në të kaluarën, por, edhe drejt së ardhmes, një dritare nga mund të shikohet në brendësi të Dukagjinit dhe dukagjinasve, në shpirtin e tyre, në zemrën e tyre.

Gazeta “Dukagjini” pasqyroj dhe vazhdon të pasqyrojë historinë e kulturën tonë, ndjenjat tona të palëkundur në kulturën materiale dhe shpirtërore, pasuritë natyrore, por dhe vazhdon të propozojë ide për zhvillimin e krahinës, integrimin në vendbanimet e reja të bashkëkrahinarëve tonë që kanë zbritur në zonat fushore, qytete apo edhe jashtë vendit.

Në faqet e kësaj gazete janë bërë përpjekje të suksesshme për të qëndruar larg urrejtjes, konflikteve, ambicies negative, inateve, e të tjera. Ajo, ka diskutuar fuqishëm në lidhje me këto fenomene që vazhdon të marrë edhe jetë njerëzish në krahinën e Dukagjinit, por edhe më gjerë, ka tërhequr mendime dhe ide për të ardhmen, dhe ky mision i saj do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Në numrin e parë, që doli me 30 dhjetor të vitit 2003 u shënua, se po çelët një dritare historike për të parë jetën dhe botën brenda vetvetes, por edhe rreth e rrotull territorit dukagjinas, rreth e rrotull bashkësisë dukagjinase. Gazeta “Dukagjini” jehoj 150 herë, shumë fuqishëm, shumë bashkëpunuese dhe dashamirëse. Që nga ajo ditë kjo gazetë është bërë një dritare në “kullën” e fuqishme dukagjinase, për të ndriçuar brenda saj me një dritë të pastër, të mirë dhe fuqishëm, por edhe për të parë jashtë, zhvillimin dhe përparimin bashkëkohor, për tu integruar në jetën e përditshme, për tu zhvilluar e përparuar frontalisht në rrugët e historisë, kulturës dhe shkencës, duke u bere pjesë e saj.

Shpirti, gjaku nder deje, mendja përparimtare e malësorit dukagjinas, kishin dhe kanë nevojë për udhërrëfyes, ndriçues, pishtar që ti shërbejnë për të sotmen dhe të ardhmen. Kësaj i shërben mjaftë fuqishëm gazeta “Dukagjini” nën pendën e gazetareve, bashkëpunëtorëve, dashamirësve, përhapësve të gazetës, jo vetëm brenda bashkësisë tone, por edhe në shkallë kombëtare.

Në faqet e kësaj gazete kanë lenë firmat e tyre shumë e shumë intelektual, të rinj e të moshuar, burra e gra, vajza e djem nga Dukagjini, por edhe qytetarë të zakonshëm, intelektual, dashamirës të Dukagjinit, që me pendën e tyre,

mendimet e tyre, shkrimet e tyre, kanë ndihmuar në integrimin e bashkësisë dukagjinas.

Vullnetarizmi në mbajtjen e kësaj gazete, tregon se ai nuk është shuar edhe te këta malësor, ka dëshirë për t'i shërbyer bashkësisë, për t'i shërbyer vendit. Kërkimi dhe zbulimi i historisë e kulturës së kësaj zone është pasqyruar në faqet e saj,

Gazeta “Dukagjini” është ndërtuar tërësisht mbi punën e vullnetshme, pa shpërblim, me shpirtin krijues dhe këmbëngulës të intelektualëve dukagjinas dhe mjaftë më gjerë malësorëve që kujtojnë vlerat dhe që nuk duan ti lenë të harrohen, atyre që mbajnë mend dhe interpretojnë bukur, sakte dhe me dashuri doket dhe zakonet e zonës tonë shumë të pasur dhe e të bukura. Mjaftë shpejt kjo gazetë u bë një tribunë e këndshme dhe pati e ka vend për të gjithë ata që mendojnë për të mirën e zonës, për të mirën e vendit, për të ardhmen, për vlerat që nuk duhet harruar, për tua lenë brezave që do të vinë.

Kjo gazetë del prej 13 vitesh rregullisht në Shkodër, dhe sot është e vetmja në territorin e Bashkisë Shkodër. Kjo gazetë ka bërë më të mirën e mundshme për të bashkuar mendimin e bashkëfshatarëve tonë, por edhe të autorëve të ndryshëm jo dukagjinas, përfshi edhe mendimin ndryshe, pa u ndikuar nga pikëpamjet politike, shoqërore, racore, fetare e të tjera, por që synohet për të mirën e kësaj zone. Kjo ka qenë shtylla kryesore që ka bërë të mundur vazhdimin e daljes dhe jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e saj. Ne kujtojmë daljen e numrit të parë, për lotjen e shumë pjesëtarëve të redaksisë, madje edhe puthjen e saj. Ishte këndshëm, ishte mirë. Kjo dashuri vazhdon. Sot kjo gazetë ka përhapje të mirë brenda vendit, por edhe jashtë, si në Kosovë, Amerikë, Belgjikë, Angli, Itali, Greqi, Mal të Zi, e në të tjera vende nëpërmjet faqes së internetit të saj. Natyrisht që po punohet që të ketë shtrirje edhe më të madhe.

Ne, duhet dhe do të vazhdojmë të punojmë për edukimin e tolerancës, bashkëpunimit, mirëkuptimit e integritetit të bashkësisë dukagjinas kudo që janë vendosur, ruajtjen e vlerave më të mira të trashëguara në shekuj, por edhe për mënjanimin e atyre antivlerave të trashëguara që bëhen pengesë. Ne u drejtohem të gjithë malësorëve dukagjinas që janë larguar për një jetë më të mirë kudo që ndodhen, brenda dhe jashtë atdheut, të pasqyrojnë në faqet e kësaj gazete jetën dhe veprimtarinë e tyre.

Në 150 numrat e kësaj gazetë kanë vënë firmat e tyre mbi 300 autor, shumë prej të cilëve me shumë shkrime. Ndonjëri prej bashkëpunëtorëve të kësaj gazete edhe me vështirësi fiziko-shëndetësore si Prelë Grima apo Pjetër Delia. Kjo është një pasuri shumë e madhe intelektuale për historinë e kulturën e kësaj gazete, por edhe për vetë autorët, për zonën, për gazetarinë në tërësi. Edhepër shkrimeve të këtyre autorëve, edhe vetë ne, dukagjinasit, kemi marrë shumë, shumë, informacione, të dhëna shumë

të vlefshme për të kaluarën, për të sotmen, por pse jo edhe për të ardhmen, për integrimin dhe zhvillimin e zonës dhe banorëve dukagjinas kudo që punojnë dhe jetojnë. Ne u jemi mirënjohës kësaj skuadre pararojë, jo të vogël, dhe i falënderojmë me shumë respekt për punën e tyre dashamirëse, vullnetare dhe shumë të vlefshme. Natyrisht, jemi të bindur se këta nuk e kanë mbyllur veprimtarinë e tyre publike, ashtu siç do ti shtohen edhe të tjerë, veçanërisht të rinj e të reja, intelektual dukagjinas dhe jo dukagjinas.

Shoqata “Atdhetare Dukagjini” ka marrëdhënie shumë të mira, me shumë shoqata, por lidhjet dhe marrëdhëniet me Shoqatën “Martin Dreshaj” Kosovë-Malasi e Madhe, me qendër në Pejë, janë shumë të veçanta, falë dashamirësisë dhe respektit të dyanshëm. Kemi zhvilluar shumë veprimtari të përbashkëta në Kosovë, në Shqipëri, në Mal të Zi. Këto veprimtari kanë ngritur më lartë vlerat atdhetare të shoqatave tona dhe të bashkësive ku veprojnë ato. Të gjitha këto veprimtari janë pasqyruar gjerësisht në faqet e gazetës “Dukagjini”. Në këtë mënyrë gazeta jonë është bere një urë lidhëse shumë e fuqishme midis dy shoqatave, natyrisht brenda një kombi, por që historia i ka ndarë në mënyrë të pamëshirshme dhe të padrejte. Gazeta “Dukagjini” me pasqyrimet e saj ka forcuar lidhjet, për këto shoqata dhe këta veprimtarë janë bere të pavlefshëm kufijtë midis këtij kombi, që nuk e ndajnë as gjaku, as gjuha, as doket dhe as zakonet. Kështu do të vijojë edhe në të ardhmen kjo gazetë dhe këto shoqata. Bashkëpunëtorët nga kjo shoqatë kanë lenë firmat e tyre në faqet e gazetës “Dukagjini” si Ukshin Jashari, Frashën Racaj, Rrahman Jashari, Anton Luljuraj e të tjerë, të cilët kanë trajtuar probleme të komunitetit ku veprojnë, por kanë pasqyruar edhe veprimtari të përbashkëta që kemi zhvilluar.

Do të ishte e pamundur jeta e kësaj gazete po të mos ishte shpirti dashamirës, bujaria, dhe gatishmëria e dukagjinasve, por edhe jo dukagjinasve për të përballuar shpenzimet. Janë gjendur pranë shoqatës dhe gazetës dhjetëra persona, të cilët nga të ardhurat e tyre mundësojnë botimin e gazetës. Ne u jemi shumë mirënjohës të gjithë këtyre dashamirësve të gazetës “Dukagjini”, por është vendi që të veçojmë veçanërisht ata që ndihmojnë gazetën më muaj e vite si Gjergj Leqejza, Ndue Ftoni, Mhill Prroni, Gjergj Vocaj, Gjekë Sokoli, Pal Lera, Bal Vuksani, Gjovalin Shyti, Pal Gjolaj, Anton Kosteri, Tonin Marku, Vatë Musa, Pal Troshani, të tjerë. Puna vullnetare me gazetën, duke përjashtuar anën teknike dhe materiale, meriton vlerësim, është për tu njohur, për tu respektuar dhe për tu përshëndetur nga të gjithë lexuesit e saj.

Gazeta “Dukagjini” nuk është gazetë private dhe as e pavarur. Ajo është gazetë që punon mbi bazën e programit të shoqatës, objektivitet dhe punën e saj, dhe ka në qendër të vëmendjes realizimin e misionit, për të cilën është themeluar shoqata dhe për të cilën është

botuar edhe gazeta.

Nuk ka qenë e lehtë pasi ka vorbulla që përpiqen dhe dëshirojnë të tërheqin brenda tyre edhe gazetën tonë. Por, redaksia e gazetës, kryesia e shoqatës, bashkëpunëtorët, kanë qenë të vëmendshëm, të kujdesshëm që të ruajnë mos përfshirjen e saj në këto drejtime. Toleranca, bashkëpunimi, por edhe mendimi ndryshe, ballafaqimi apo kundërshtimi kanë gjetur vend në faqet e gazetës “Dukagjini”, natyrisht jashtë konflikteve personale, larg fyerjeve, larg nxitjeve të grupeve të ndryshme të bashkësisë, ndarjeve krahinare, konflikteve politike midis banorëve, e të tjera.

Mbështetur në programin e shoqatës dhe misionit të gazetës, është arritur që për bashkësinë dukagjinas, kudo që punon dhe jeton, gazeta “dukagjini” ka qenë avokat nga më të mirët për edukimin, integrimin dhe përparimit e tij.

Në kushtet e reja të krijuara nga ndarja e re administrative kemi përpara vështirësi, pasi Dukagjini ndahet në dy bashki, në atë të Shkodrës dhe të Vaut të Dejës. Duhet bërë përpjekje për lidhje me drejtuesit e këtyre bashkive, pasi është edhe në dobi të punës së tyre. Besojmë në mirëkuptim dhe bashkëpunim në këtë drejtim.

Në numrin e 150-të të gazetës “Dukagjini” duhet falënderuar zotin Prelë Milani dhe Lazër Kodra ish kryeredaktor paraardhës, për punën e tyre, gjithë redaktorët, bashkëpunëtorët e gazetës dhe korrespondentët, të cilët po mbajnë gjallë frymën e vëmendshme në këtë gazetë. Duhet falënderuar edhe kryetari i shoqatës Ndue Sanaj, që edhe në punon me gazetën, ka qenë shumë aktiv, deri edhe në redaktim, faqosje, shpërndarje, sigurim fondesh, e të tjera.

Me gjithë vështirësitë e punës dhe të kohës, Shoqata “Atdhetare Dukagjini” dhe gazeta “Dukagjini” ka arritur të humtojë dhe të publikojë vlera shumë të larta dhe të shumta të kësaj zone dhe të kësaj bashkësie. Pa mëdyshje mund të pohojmë, se kemi bere sa nuk është bere historikisht për vlerat në të gjitha drejtimet, pavarësisht vështirësive, që pengojnë dhe vjeljen e mendimeve për të ardhmen. Kjo është e prekshme qartazi dhe për këtë jemi shumë të gëzuar, por ndjejmë edhe krenari që i kemi shërbyer vendlindjes tonë të mirë, i kemi shërbyer bashkëkrahinarëve tanë, vetes tonë. Çfarë është bere e mundur deri tash ka shumë, shumë vlera, për këtë zone, prandaj puna e shoqatës dhe gazetës së saj duhet dhe do të vijojë përsëri duke u mbështetur te intelektualët tonë dhe më gjerë, te studiuesit dhe bashkëpunëtorët tonë.

Gazeta “Dukagjini” duhet dhe do të vijojë në këtë vijë, si deri në sot. Ne, shikojmë se kemi rezultate të dukshme, por, duhet të bëhen përmirësime në përmbajtje, cilësi, pasurim me fotografi, më shumë larmi rubrikash, kuriozitetet shkencore, fjalë të urta, shkrime nga nxënësit të dalluar, shkrime për njerëz punëtor, të moshuar e emër mirë, portrete, shkrime shkencore, shkrime problemore, duke u mbështetur në vlera, që i qëndrojnë kohës.

Luigj SHYTI
Kryeredaktor

SHOSHUANËT E BREGUT TË BUNËS

Palajt e Shirqit

Në fshatin Shirq të Komunës Dajç Bregu i Bunës jetojnë një lagje me 40 shtëpi me origjinë nga fshati Palaj i Shoshit. Sipas pemës gjeologjike i pari këtij fisi ishte Kin Hila i vllaznisë Gjineshaj i larguar nga fshati mëmë i Palajve të Shoshit për arsye e hasmërie. Kinin e vogël babai e la jetim dhe në gjak. Nëna për të shpëtuar jetën e djalit të saj e la vatanin e baballarëve të djalit si tokë në gjak dhe iku e u vendos në Shirq të Bregut të Bunës. Sipas traditës Kinë Hila sa po mbushi 14 vjet, vrau katër asqer turq dhe morri arratinë në dhera të tjera jashtë Shqipërie për t'i shpëtuar ndëshkimit otoman. Pas 12 vjetësh me sa duket pas largimit të përfundimtarë të osmanve, kthehet në fshatin e tij një natë të acartë dimri duke trokitur në derën e një jerevije të varfer ku jetonte nëna e tij. O manë ma hap derën; thirri Kini nga jashtë në mesin asaj nate sterrë pa hënë. Kini nuk ashtë në shtëpi. Unë derën pas mesnate nuk ja hapi kurrkujt. Në paç ardhë për punë të liga t'ue mendua se jam grua e pa mashkull në shtëpi qebesa e zotit, po nuk mu largove prej oborrit kërciti pushka qetesh mbi ty! Qebesa e Zotit moj nanë jam Kini djali yt! Po nuk e besove qe unazën tande që e kam pas si shenj me veti gjithkrah i kam ra tash 12 vjet. Kini i holl i unazën për vrimës së dritares dhe kur nana po unazën e vet. Hapi derën duke thirr me të madhe ardhsh i bardh e

Tabela krahasuese gjeologjike e familjeve së Kin Hiles (Shirq) me Hilë Grimcin Palaj - Gjon Kolën SHBA të gjithë dege të vllaznisë Gjineshaj - Palaj- Shosh

1	Gentjan Kin Hila	Sander Gjergji	Nikollë Gjergji
2	Kin Marku	Gjergj Hila	Gjergj Hila
3	Mark Jaku	Hilë Grimci	Hilë Boxhoja
4	Jak Marku	Grimc Ndreu	Boxho Gjeloja
5	Mark Kini	Ndre Papa	Gjelo Gjoni
6	Kin Hila	Pap Nika	Gjon Kola ¹
7	Hil Mshkali	Nikë Pali	
8	Mëshkali Pali		
9	Pal Gjoni		
10	Gjon Pepa		
11	Pep Gjini		
12	Gjin Nika		
13	Nikë Pali		
14	Pal Pepa		
15	Pep Gjoli		
16	Gjol Suma njeri dy atashet e Shoshit		

Siç shohet nga tabela dy degëzimet e para takohen pas 7 brezash, ku vlen të theksohet se Kin Hila është larguar nga Palajt e Shoshit para 6 brezash, kurse me shtëpinë Gjon Kolës brezat e sotëm të as njerës palë nuk janë në gjendje të tregojnë pikëtakimin e gjeneratave pra ardhëse, por një është lehtësisht e lexueshme se Gjon Kola është larguar para 6 brezash nga Palajt, duke humbur po thuaj çdo lidhje me burimin amë.

mirë se të ka pru i madhi zot e kjo natë!. Djalë e nanë u morën gryka - gryka dhe u shkrenën vajë duke qa me lot madhi e gëzimi të pa përshkuar ¹. Kin Hila u 1 -Tregua nga 80 vjeçari, Mark Jaku, 75 vjeçari Tish Jaku dhe Jak Marku, banorë të

martua dhe i lindën 6 djem, katër prej të cilëve jetuan dhe formuan katër barqet e kësaj dege të Gjineshajve të Palajve në fshatin Shirq. Pasuesit sotëm e Kin Hilës së Shirqit me vëllezërit (Gjergj e Mark Hila) të Palajve, e Shoshit kanë si **nyje gjeologjike lidhëse të parin e tyre të përbashkët Nikë Pali në distancë 6 (gjashtë) breza nga njeri-tjetri**. Po thuaj në të njëjtën kohë me Kin Hilën nga Palajt është larguar edhe Gjon Kola i cili fillimisht u vendos në Shirq, më pas emigroi në Pobraçe Reç të Malit të Zi, ndërsa sot tre familjet e vetme të këtij trangu jetojnë në SHBA. Informatorët Mark dhe Tish Jaku banorët më të vjetër të këtij fisi deklarojnë se Kin Hila dhe Gjon Kola janë të një fisi nga Palajt e Shoshit por nuk janë në gjendje të bëjnë lidhjen gjeologjike të dy palëve.

Shtëpia e Kin Hilës

Kin Hila pati kater djem:
Mark Kinin Hila
Tol Kinin Hila
Zef Kin Hila
Krac Kin Hila
Barku i Mark Kin Hilës

Mark Kin Hila babai i Jakut, Luigjit, Dedës, Tishit, Markut, Filipit, Linit dhe Cinit

Luigj Jaku babai Çeskut (2 djem), Kastruotit, Tinit

Dedë Jaku baba i Shtjefnit (2 djem), vllaznisë Gjineshaj (Palaj Shosh) me banim të kahershëm në fshatin Mushan.

Gjokës(3 djem), Pavlini (1 dialë)

Tish Jaku babai i Jacit, Lekës(2 djem), Brozit (1 dialë) dhe Balonit (2 djem), Valentinit (2 djem)

Mark Jaku babai Kinit(3 djem),Tonit, Serafinit (1 dialë), Benardinit(2 djem)

Filip Jaku babai i Rrokut(3 djem), Salbvadorit(2 djem)

Lin Jaku babai Valentinit² (1 dialë), Wilsonit dhe Arjanit (1 dialë)

Cin Jaku baba i Taulaniti dhe Enrrikut

Shtëpia e Gjon Kolës Gjon Kola u largua nga Shoshi

Gjon Kola babai i Ndojës dhe Gjelos.

Ndue Gjoni pati një vajzë

Gjelo Gjoni babai i Kolës dhe Boizhos: **Boxho Gjeloja babai i Hilës dhe Ndreks**

Ndreks Gjeloja nuk pati dialë

Hilë Bozhoja babai i Tomës Zefit dhe Gjergjit

Zef Bozhoja babai i Markut, Hilës dhe Antonit

Gjergj Bozhoja babai i Nikollës dhe Sandrit.

Tomë Bozhoja nuk pati trashigimtar

Tre familje te kësaj dere jetojnë në SHBA, ku të paret e tyre janë larguar fillimisht nga Palajt, në Mushan, pastaj Pobraçe Reç të Malit të zi dhe së fundi në Amerikë.

Përgatiti Prele Milani, poet, publicist

² - Valentin Jak Pali, ka qënë deputet i PD në parlamentit shqiptarë për dy legjislatura

Përkufizimi i Patriotizmit Si shkruanin paraardhësit

Nga Ernest Koliqi

Fjala "patriotizëm" asht mënyrë kumbore qi përdoret retorikisht në vend të fjalës, "atdhedashuni". Nga ky zevendsim rrjedh një ndërlirim ase nakatosje edhe në kuptim. Nji ndiesi e thjeshtë, e natyrshe si atdhedashunija shëndrrohet në nji virtut të rrallë, të pikatëshëm, frymzues veprash të veçanta. Ndoshta kjo ndiesi, d.m. th. atdhedashunija e naltueme në shkallë heroike dh'e quejtun patriotizem, para pamvarsis shqiptare, ishte vërtetë pajë e të pakvet dhe kërkonte vetëmohim e shpirt herorizimi sepse atëherë veprimtaria për liri t'atdheut shkaktonte salvime.

Shumica, asokohe e plandosun në terr të padijes e në verbim fanatizmash fetare e krahinore, ata qi flijoheshin për të përtrim të nji Shqipnija së pamvarun nuk i kuptonte, i përbuzte, nganjihërë edhe i mëniente, ma shpesh i njehte rrugacë mendjekrisun e djerraditë. Prandej patriotat ishin të përndjekun, të burgosun e

të vram.

Por sot atdhedashunija asht detyrë e çdo Shqiptarit qi nuk i bjen mohit prejardhjes së vet. Mjerisht shofim se, ndër mërgimtarë, shumkush s'e kupton në thelb fjalën atdhedashuni. Disa mendojnë se atdhedashunija dishmohet me punë trimnija, me kapadaillek, shkurt tue qitë pushkë e tue përdorë thikën, tue vra e therë njerëz. Gabohen. Shqipnija dashunohet tue i a ruejtë nderin, sidomos në vend të huej.

Heroizmi çmohet e përlavdohet kur lulzon me vend e me kohë. Guximi kriminal i gangsterave nuk hyn në radhën e veprave heroike. Sidoqftë, rasat për të veprue si herë janë të rralla dhe më të shumtën e herës kanë të bajnë me energji mora-



le dhe trimni civile më tepër se me përdorim t'armës. Atdhedashunija e vërtetë qindron ne në ushtrim të përditshëm të vetive me të zgjedhuna njerzore e kombtare, sidomos në mërgim. Je atdhetar? Mos i a nxij fytirën Shqipnis. Nderi i atdheut ruhet me sjellje t'urta, dhe të përditëshme. Çdo marrëdhënje me të huej sherben me i a forcue e shtue namin e mirë Shqipnis. Ase, anasjelltas, m'e koritë emnin shqiptar. I hueji mbi Shqipni din pak ase aspak. Po diji pak, zakonisht i shikon Shqiptarët si njerëz primitive, d.m.th. barbarë. Kanë ba propagandë të madhe anmiqt e kombit mbi të pandehunat veti prapa-

nike të kombit t'onë Njani siysh lajmoi botën se Shqiptarët kanë bisht në fund të shpinës. Lypet urti e madhe nga ana e jonë, përjashta, për të përgënjeshtrove pohimet antishqiptare t'atyne qi dojshin me shtri sundimin mbi tokë t'ona, tue na përshkrue si njerëz të paaftë me u vetqeverisë. Çdo vepër e pagjashme vërteton akuzat kundërshtare. Siellesh me urti e me nderë në vendin ku punon, paraqitesh njerzisht ndër të huej me të cilët ke marrëdhanje, me autoritete të shtetit qi të dha strehim? Ke krye nji vepër patriotike më të madhe se me qitë pushkë për çështje shpesh të keqkuptueme nderi a prestizhi. Të rregullohemi në mënyrë qi, kudo në botë na hodhi murrani i fatkeq-sive kombtare ase vetiake, tue shqyrtue të prumit t'onë I hueji të mendojë e të thotë: " Burra të mirë këta Shqiptarët. I a marrët të keqen kush flet keq për ta ".

Marrë nga "Shejzat", mars 1971

Agron Fico, misionar i përkushtuar i shqipësisë

Kopi Këcyku

Nuk ka gjë më të çmuar për një komb se sa gjuha amtare, sepse kjo është mushkëria me të cilën ai merr frymë. Përmes shqipërisë ia dalim mbanë të përshfaqim krejt botën tonë të brendshme, të shprehim atmemëdhedashurinë, dhe krenarinë që kemi lindur shqiptarë. Vlera e pakrahasueshme e gjuhës amtare shpjegohet me tharmin, huret e sidomos me aftësinë e saj për të pasqyruar krejt historinë kombëtare, me gëzimet dhe trishtimet e saj, ëndrrat e përbushura dhe shpresat e pluhuruara nga rrethanat e pafavorshme nëpër të cilat kemi kaluar. Në gjuhën amtare gjendet i gdhendur kujtimi i së kaluarës, i virtyteve tona stërgjyshore, i rrënjëve zanafillore. Gjuha amtare është një thesar që nuk shitet, as blihet, por mund të trashëgohet, të ruhet e të pasurohet me përkushtim. Ajo përbën shansin që kombi ynë të jetë i pranishëm si personalitet në arenën ndërkombëtare, të ekzistojë në shekuj dhe t'u bëjë ballë uraganeve të mundshme të çdo lloji. Mbi të gjitha, ta çmosh, ta duash, ta respektohet gjuhën e të parëve të tu, është detyrë e shenjtë për cilindo nga ne, kudo që ndodhemi.

Nuk duhet të harrojmë që duke lëvruar e mbrojtur gjuhën amtare, pra sinonimin e kombit e të identitetit kombëtar, përmes saj rilindësit shpalosën platformën për liri e pavarësi. Në ecurinë e kombit, gjuha, me misionin thelbësor të komunikimit, të nxitjes dhe të ushqyerjes së qytetërimit, përbën elementin më të rëndësishëm të ngjizjes së unitetit mbarëkombëtar. Më tej akoma: gjuha mishëron vetë qenien e kombit në tërësinë e tij.

Krahas historisë dhe besimit, gjuha ka përligjur dëshirat dhe të drejtat e shqiptarëve, u ka çelur horizonte dhe perspektiva, duke u dhënë luftrave dhe përpjekjeve të tyre fuqinë, këmbënguljen e patosin veçorizues.

Gjuha amtare jo vetëm duhet folur e shkruar, por edhe duhet studiuar qysh kur lindemi e deri kur vdesim. Sepse gjuha, si e tillë, përfaqëson ndoshta dukurinë më komplekse njerëzore dhe njëherazi të evolucionit të natyrës, etapë e epërme e cefalizimit të biosferës së planetit Tokë. Është mëkat kur vemë re që jo pak nga ne e flasin pa ndjenjë përgjegjësie ose, – ca më keq, – e këqyrin me një farë shpërfilje, duke parapëlqyer gjuhët “e mëdha”. Ky qëndrim, ndër të tjera, shkaktohet nga mosnjohja e vlerave të shqipërisë.

Nga ana tjetër, në një kohë që nuk mburrimi dot, – dhe as që duhet të lakmojmë! – me lëshim raketash në hapësirën e lartë apo me armë të sofistikuara të shfarosjes në masë, – kemi të drejtë të ndjehemi krenarë që gjuha jonë, një nga më të hershmet e planetit, është e gjallë, pasurohet e përkryhet parreshtur, jep e merr me simotrat e saj, madje ndihmon në shpjegimin e shumë dukurive që lid-

hen me zanafillën e historinë e zhvillimit të tyre etj.

Gjuha shqipe ngjan me një nuse të bukur që nuk plaket kurrë, e freskët, e virtytshme, që respekton traditat e kombit, por nuk është aspak fanatike, e vetëmbjellur në guackën e saj. Përkundrazi, gjatë komunikimit të lirshëm, shprehet me ma-



turi e mençuri duke merituar vëmendjen dhe respektin e të gjithëve. Pra është e hapur për gjithçka. Kjo është njëra nga arësyet që interesin për ta njohur dhe për ta mësuar me themel shqipërisë ka ardhur duke u rritur gjatë kohërave, jo vetëm nga specialistët e lëmit të gjuhësisë, por edhe nga përfaqësuesit e fushave të tjera dhe nga njerëzit e thjeshtë. Rol të pazëvendësueshëm në këtë drejtim luajnë “misionarët” e përkushtuar të saj, ata që e shohin si detyrë të perëndishme, të shenjtë, përhapjen dhe njohjen anekënd të vlerave të shqipërisë. Emrat e Kristoforidhit e të Naimit i frymëzojnë dhe ua shtojnë forcat dhe entuziazmin për të mos u ndalur për asnjë çast.

Një i tillë është edhe profesori Agron Fico. Qysh më 1958, me të përfunduar Fakultetin e Historisë e të Filologjisë (degën gjuhë-letërsi) në Universitetin Shtetëror të Tiranës, atij iu besua mësimdhënia e shqipërisë në grupin prej katër gjermanësh; më pas një grupi tjetër koreanësh, kinezësh, mongolësh, çekësh... Të gjithë ishin studentë dhe, me kalimin e kohës, u bënë albanologë e diplomatë të zotë. Ndonjërit, si gjermani Fiedler, tashmë njohës i thellë i shqipërisë, profesori Agron Fico i shpjegoi me durim dhe kompetencë, gjashtë muaj me radhë, trajtat e shkurtra të përemrave vetore dhe “delikatësia” të tjera të kësaj natyre. Edhe punonjësit e Ambasadës së ish-Bashkimit Sovjetik në Tiranë nuk mbetën pa kërkuar ndihmën e kualifikuar të profesori Agronit, falë të cilit përvetësuan bazat e shqipërisë së folur e të shkruar.

Në periudhën 1961-1965 profesori Agronin e shohim në Universitetin e Pekin-

it. Aty krijon dhe drejton me autoritet të lartë shkencor katedrën e shqipërisë, harton metodika dhe tekste mësimore, që do të përdoren nga një numur gjithnjë në rritje studentësh të shqipërisë. Agron hedh idenë, nxit dhe jep ndihmesë konkrete për fillimin e transmetimeve të emisioneve në gjuhën shqipe nga Radioja

tre kontinenteve”, e shohim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Universitetin e Miçiganit. Atje shkon si i ftuar. Ngre në këmbë katedrën e gjuhës dhe të kulturës shqiptare. Në Universitetin Kolumbia, organizon një kurs të posaçëm nëntëmujor me studentë të vitit të tretë në degën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Për meritat e mëdha në fushë të mësimdhënies së shqipërisë, por edhe në fusha të tjera të kulturës e të dijes, përfshihet në Enciklopedinë Eho's Eho e zgjidhet nënkryetar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane. Profesori Agron ka këmbëngulur dhe ka bërë të mundur dërgimin për studime në SHBA të një numuri të madh shqiptarësh.

Profesori Agron Fico ka dhënë për një kohë të gjatë mësim në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Akademinë e Arteve dhe në Institutin e Lartë të Fizkulturës “Vojo Kushi”. Vital, si gjithmonë, tani është bashkërendues dhe drejtues i katedrës së gjuhës angleze në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, merr pjesë aktive me referate dhe kumtesa në veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, shkruan e boton materiale publicistike etj.

Në të gjallë të tij, i pavdekshmi Eqrem Çabej pat thënë: “Agron Ficoja është i ri, por ka stofë prej shkencëtari të formuar”. Ndoshta këtë pati parasysh dekanin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit “Eqrem Çabej”, kur, me rastin e dhënies Agron Ficos të titullit “Qytetar Nderi i Gjirokastrës”, u shpreh: “Kemi të bëjmë me një trekëndësh të shqipërisë: Çabej e përpunoi, Kadareja e shkroi, Ficoja e përhapri nëpër botë”.

RESPEKT PËR FRAN ZEQRIR GJELOSHIN



Fran Zeqir Gjeloshi lind me 2 qershor 1932, në fshatin Gimaj, me arsim 7 vjeçar. Në vitin 1951 është thirrur ushtarak, në rrethin e Delvinës. Për kryerje të shërbimit ushtarak shembullor, është dekoruar me medaljen e shërbimit ushtarak.

Me përfundimin e shërbimit ushtarak, është veshur në radhët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në detyrën e policit, në të cilën ka punuar disa vite, në Shkoder, Koplik dhe komandant poste në krahinën e Shoshit.

Më vonë ka marrë pjesë në ndërtimin e Hidrocentralit në Vau-Dejës, Fierze dhe Koman. Për punë të mire, është dekoruar dy here me medaljen e Punës.

Frani është martuar me Leze Vaten, nga fshati Lekaj, të cilët kanë qene një çift shembullor. Kane 8 fëmijë, të cilët i rriten, i edukuan dhe i shkolluan në mënyrë shembullore, dhe janë të nderuar kudo, në Dukagjin e në Shkoder.

Me datën 21 mars 2016 u nda nga jeta dhe ju dha lamtumira e fundit. I përjetshëm qofte kujtimi i Fran Zeqir Gjeloshit!

Përgatiti Zef Nika

AMBASADORI NGA DUKAGJINI

Tervesa shqiptare, në shtëpinë e biznesmenit Ndue Ftoni në Detroit

Zona e Dukagjinit zë pjesën më të madhe të Alpeve Shqiptare. Kjo krahinë në zemër të maleve është e shquar për bukuritë e rralla dhe të egra, për luginat dhe ujjat e kristaltë të përronjëve dhe lumenjve që zbresin nëpër rrugë shkëmbore, deri poshtë në fushën e Shkodrës.

Kjo krahinë e bekuar nga Zoti shpaloet përpara çdokuj që e sheh për herë të parë, si një pikturë madhështore me jeshilen e thellë të pyjeve, me grinë e kristaltë të shkëmbenjve dhe me kapuçin e bardhë të dëborës në majat e maleve.

Dukagjini ngjason me një kështjellë gjigande, dëshmitare e pamposhtur ndaj çdo tentative për ta pushtuar. Ai ka nxjerrë nga gjiri i saj burra trima me zë, mendimtarë të shquar, prijës që kanë bërë emër që nga lashtësia e deri më sot, ku trashëgimtarët e tyre japin kontribut, jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe deri në Amerikën e largët.

As tentativat e dimrave të egër alpin, apo dimrave të dhunshëm komunistë, nuk arritën kurrë ta izolojnë Dukagjinin dhe banorët e tij. Ata u integruan pas ndryshimeve demokratike të barabartë si të gjithë shqiptarët, madje karakteri burrëror dhe intiligjenca e lindur i vunë ata në pararojën e ndryshimeve të thella në Shqipëri pas viteve '90.

Të tilla figura, bij të Dukagjinit i gjen sot në sfera të ndryshme të jetës sociale, ekonomike e politike të vendit, nga kuvendi i Shqipërisë deri tek organet administrative, në veprimtaritë ekonomike kapitaliste dhe në ato social-kulturore.

Në këtë shkrim unë zgjedha të flas për njërin prej tyre, birin e Dukagjinit, biznesmenin e suksesshëm, të njohur në Shqipëri

dhe Amerikë, z. Ndue Ftoni, të cilin do ta quaj zëri shqiptar i jetës së biznesit, që ka bërë aq shumë me investimet e tij mendore dhe kapitale për progresin, jo vetëm të vendlindjes, por të gjithë shqiptarëve në përgjithësi.

Sigurisht që unë nuk e kam të mundur t'i përmbledh të gjitha sukseset e këtij malësori, që bëri dhe po bën emër në Amerikën



e largët, por e quaj veten me fat që pata mundësinë kur isha në Amerikë në një aktivitet kulturor, me ftesën e z. Ftoni të isha i pranishëm në të gjitha bizneset e tij, si dhe në disa nga aveprimtarite kulturore e artistike që organizoheshin në "The Imperial House" pronë e tij, ku u takuam nga afër dhe shkëm-

byem së bashku mendime dhe fjalë që nuk do të më shlyhen kurrë nga kujtesa ime. Në këtë ambient, në një mbrëmje festive pata fatin të takoj edhe artistë të shquar nga Shqipëria e Kosova si Irini Qirjaku, Rovena Ibrahim, Aida Cara, humoristi i mirënjohur shkodran Besnik Çinari e të tjerë.

Ndue Ftoni është biznesmen i suksesshëm dhe humanist i pashoq, pronar i Televizionit "ACTV", me seli në Qendrën Ekonomike dhe Kulturore "The Imperial House", një shqiptaro-amerikan që rreth 20 vite jeton dhe vepron në Michigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ai është larguar nga vendlindja e tij dhe ka shkuar i vetëm në mërgim, duke lënë familjen në Shqipëri. Në këtë shtet të madh ditët dhe kohët e fillimit ishin shumë të vështira, pasi ai nuk dinte gjuhën, zakonet dhe mënyrën e jetesës. Por falë Zotit dhe bujarisë amerikane, si dhe përkrahjes së shqiptarëve që gjeti atje filloi të përballojë vështësitë e fillimit. Por kjo nuk do të vazhdonte shumë gjatë, sepse shpejt do të vinte një ditë që veprimtaria e Ndue Ftonit do të ishte një realitet i pasqyrit jo vetëm të aktivitetit të tij dhe qendrës ekonomiko kulturore "The Imperial House", por e gjithë veprimtarisë së shqiptarëve në Amerikë.

Në komunitetin shqiptar të Michiganit dhe në gjithë Amerikën mike, Ndue Ftoni tregon një zemërgjerësi për t'i mundësuar financiarisht ngjarjet më të rëndësishme kulturore, që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe gjithë Kombin Shqiptar. Dhe këto nuk kanë qenë të pakta, por herë pas here ka mundësuar shumë veprimtari me karakter lokal, si ato të zonës së tij, Dukagjinit, por edhe të qytetit të

Shkodrës e më gjerë, ku mund të përmendim prej shumë vitesh gazetën "Dukagjini", si dhe ansamblin "Treva" të Dukagjinit. Po ashtu ka ndihmuar dhe shumë familje në nevojë e raste të tjera, jo vetëm në punësim, por edhe me ndihma monetare e materiale.

Ndër veprimtaritë e shumta që Ndue Ftoni ka organizuar si biznesmen në qendrën shqiptare "The Imperial House" vend të veçantë zë edhe mbrëmjet festive e mundësuar prej tij me më shumë se 1200 pjesëmarrës, me rastin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Një veprimtari tjetër i përvitshëm dhe shumë i suksesshëm është shtrimi i një terese në çdo muaj maj, në Detroit, me pjesëmarrjen e shumë artistëve shkodranë me emërtimin domethënës "Nata shkodrane".

Sa herë që z. Ftoni vjen në Shqipëri, pra në Shkodër, ai para largimit shtron rregullisht trevesen bujare për t'u takuar me miq e shokë, si dhe personalitete të kulturës dhe artit, duke e kthyer këtë trevese, në një festë thellësisht shqiptare me këngë, valle, folklor dhe humor, që tregojnë jo vetëm ndjenjat dhe dëshirat e këtij burri, por mbi të gjitha idenë e madhe të bashkimit vëllazëror.

Në këtë trevese çojnë dollitë e tyre edhe personalitete të shquar, kontribues të kulturës shqiptare me veprat e tyre, që nga dramaturgu i madh Fadi Kraja, e deri tek lahutari me zë Pjetër Matusha, i cili me këngën e tij, krijimtari e poetit të njohur popullor Gjovalin Dushaj, kushtuar këtij mikpritësi bujar, ishin ilustrimi më i bukur dhe falenderimi më i ngrohtë që i bënin të pranishmit.

Përgatiti,
Ramazan Çeka, prill 2016

KËNGËT FOLKLORIKE DHE KOSOVARE I KAMIA PËR ZEMËR..!

Bisedoi: Beqir M. Cikaqi

U bënë 10 vjet që e njoha Gjin Shani. Ishte viti shkollor 2005/2006, kur ishim gati me prezantuar programin para bashkatdhetarëve me nxënësit e Shkollës Shqipe të Basanos, drejtuesit e Shoqatës "Bashkimi Kombëtar" dhe aktivistët tjerë shqiptarë që jetojnë në këtë pjesë të Italisë. Para programit na u prezantua një treshe e të rinjve (Gjelosh Hajdari, Ali Kurti dhe Gjin Shani) që shprehën dëshirë të paraqiten me një pikë muzikore. Natyrisht se në gatishmëri të tyre s'kishim aspak hezitim që të iu krijoja hapësirë për paraqitje, pasi unë isha përgjegjës i programit. Paraqitja ishte shumë e suksesshme. Andaj që nga atëherë në çdo program për bashkatdhetarët nga atëherë kanë marr pjesë, herë si treshe, herë si dyshe, herë si individ....

Se kush është Gjin Shani sot, cila është jeta dhe zëri i tij, që e bëri tashmë të njohur jo vetëm në këtë pjesë të Italisë. Për më shumë do të njihemi me bisedën-intervistën që e zhvillova ditë ma parë, në prag të Ditëve "Epopeja e UÇK-së" ku si shkasë ishte kënga e tij që i kushtohet Komandantit Legjendar Adem Jasharit.

- Shkurtime me një profil i juaj!

Jam i lindur me 8 gusht 1978 në fshatin Ndrejaj, komuna Shosh (Dukagjin), rrethi Shkodër. Fëmijëria dhe rinia më ka shkuar shumë mirë falë zotit, familjes time dhe njerëzve që më kanë rrethuar dhe mbështetur pa kufi. Gjëja ma e bukur që kujtoj për

fëmijëri është shkolla, ku mbajë mbresa të pa shlyera. Për sa i përket rinisë së hershme kam kaluar në vendlindje, por si shumë të rinj shqiptar për të siguruar një jetë ma të mirë e komode, mora rrugën e kurbetit, dhe tani kam mbi dhjetë vite jam këtu në Itali...

Këtu (në Itali) fillimisht derisa jam sistemuar me dokumentacione të nevojshme e të domosdoshme (leje pune, leje qëndrimi, banim, etj.), me këngën pak jam marr, ndërsa tani që disa vite kam një përkushtim ma të madh për këngën ku jam prezent në manifestimet dhe përvjetorët e festave kombëtare e shtetërore, jo vetëm në provincën e Trevisos ku jetoj, por edhe ma larg deri në Perugia, madje edhe jashtë Italisë, si në: Slloveni, Zvicër, Gjermani, Austri, etj....

- Kur keni filluar të këndonit, të kujtohet paraqitja e parë para publikut?

Eh...! Për të kënduar sikur më thonë familjarët, kam nisë të këndoj refrene këngësh sapo kam folur! Por, para publikut kam kënduar në moshën 9 vjeçare së bashku me vëllanë tim Gjovalin Shani. Festoj 1 Maji me një program në Kodrën e Shëngjergjit, kur kam kënduar këngën e "Zylo Kamberit". Si fëmijë kam ndier emocione të veçanta!

- Këngën e keni hobi apo trashëgimi familjare?

Me thanë të drejtën këngën fillimisht e kisha hobi, por edhe trashëgimi familjare, sepse vëllai im Gjovalin Shani është ndër këngëtarët folklorik ma të mirë në Shqipëri, të cilin e përshëndes dhe e falënderoj shumë,

për të gjitha ato që ka bërë për mua, sidomos në profesionalizimin si këngëtar.

- Më lehtë e ke të këndon vet apo në duet?

Megjithëse unë kam kënduar gjithmonë me vëllanë tim në duet sa isha në atdhe, me ardhjen time në kurbet gjërat ndryshuan, sepse kurbeti dhe largësia i kanë të mirat dhe të këqijat e veta. Me fjalë tjera më është dashur të përshattem në këndim vet! Tani, për mua nuk ka ndonjë diferencë nëse këndoj vet apo në duet.

- Cili është zhanri i këngëve që këndon?

Unë këndoj këngë popullore e folklorike me gjithë qejf, por, muzikën folklorike e kam ma për zemër, andaj edhe këngët folklorike i këndoj me përkushtime të veçanta...

- Këndon këngë me motive nga Kosova, cilat janë arsytet që të nxisin?

Arsyetet që pse këndoj këngë me motive nga Kosova as vet nuk mundem ti shpjegojë saktë! Megjithatë, vuajtja e persekutimi që kanë pasur, mandej, trimëria e heroizmi, sakrificat e vetëflijimit, humaniteti e solidariteti, ... janë virtute që i kam vërejtur te kosovarët, dhe më ka nxitur e më nxisin vazhdimisht. Me fjalë tjera, krahas këngëve folklorike i kam shumë për zemër edhe këngët kosovare. Më pëlqejnë shumë dhe gjithë kohën e lirë që kam dëgjoj këngë kosovare ose me motive nga ajo pjesë e shqiptarisë.

- Ke disa këngë të incizuar, ke plane të incizin të tjera?

Kam incizuar disa këngë, ndër ato është edhe kënga për Komandantin Legjendar Adem Jashari dhe familjen e tij. Shpresoj që edhe albumin ta publikoj këtu vit. Kam disa plane për këngë të reja, ku teksti i një kënge

që më pëlqen është këngë për Kosovën, ku shpresoj që do të pëlqehet nga të gjithë.

- Për veq në manifestime të migracionit shqiptar në Itali, këndon edhe në...?

Kam bashkëpunim me disa televizione me të cilat bëjë publikim e incizime të mia, si me Blu Sky, TV1, TV Koplik, etj. Po këndoj edhe në gëzime familjare dhe më presin shumë mirë, për çka ndihem shumë lumtur e i relaksuar. Kam kënduar edhe në Kosovë në dasma e gëzime familjare, duke përjetuar emocione të veçanta.

- Këngët i ke autoriale (ku i merr tekstin), apo këngët i përpunon?

Këngët e mia te incizuar deri më tani i kam autoriale. Tekstin e këngëve i kam nga tekst shkruesi dhe këngëtar Fran Kodra, nga profesori Kadri Fikaj dhe Qazim Çela. Por edhe nga miku im Pjetër Kola. Unë mendoj, sa do këngëtar i mirë të jesh, po nuk bërë këngë të reja nuk ke asnjë përfitim, asnjë afirmim, sepse publiku donë vetëm gjëra të reja.

- Për fund të kësaj bisede, ke diçka që nuk është thënë e ia vlen të thuhet?

Sa do që bëjmë biseda, kemi zhvilluar edhe në të kaluarën, unë mendoj që gjithnjë mbetet diçka pa u thënë. Të falënderoj për të gjitha publikimet që ke bërë rreth aktivitetit të mërgatës se këtushme shqiptare në përgjithësi dhe për paraqitjet e mia në veçanti nëpër këto evenimente. Krahas këtij falënderimi, përzemërsisht të uroj për punën dhe aktivitetin që bënë me Shkollën Shqipe të Trevisos. Meqenëse jemi në prag të festës së Pashkëve: Ju uroj të gjithë shqiptarëve nëpër botë

GËZUAR PASHKËT!

Ç'është Dita e Verës?

Është dita në të cilën stërgjyshit tanë, kur skish lindur ende krishterimi, kremtonin bashkë me romakët dhe me grekët e vjetër, perënditë e lulevet, të shëlgjevet. Kur shkrin dimri, kur qaset vera buzëqeshur, e hollë dhe e gjatë si në pikturë të Boticellit, zemra e njeriut shkarkohet nga një barrë, shijon një qetësi, një lumtëri të ëmbël. Në këtë gëzim, stërgjyshërit tanë ndienin një detyrë t'u falën perëndivët që sjellin këto mirësira. Dhe ashtu lindi festa hiroshë që e quajmë Dita e Verës. Në pakë ditë në Shqipëri, besnikët e fundmë të paganizmit, besnikët pa dashur dhe pa ditur, do të rrethojnë me verore degët e thanave, të dëllinjave, të dafinave, të gjitha shëlgjevet të nderuara. Do të këputin degët të gjelbra dhe do t'i vënë përmbi kryet e shtëpivët. Të mos i lëmë të humbasin këto festa të vjetra të racës sonë. Nuk i bëjnë dëm njeriut. Sjellin një gëzim të kulluar në shtëpi. Një vend ku jeta e të vegjëlvët është aq e trishtuar, djelmuria dhe vajzat kanë një rastë të rrallë për të dëfryer. Për të mëdhenjtë, Dita e Verës ka një shije poetike të hollë e të rrallë.

Përshkrimin e dytë, i cili flet për kremtimin e "Ditës së Verës" nga malësorët katolikë të veriut, e kemi nga At Berdardin Palaj. Ai shkruante dy dekada pas Faik Konicës :

"Shtëpi më shtëpi në ditët e veravet, pjesëtarët e familjes bashkoheshin rreth zjarrit për me lidhë shtrigat, mgjillcat, llungjat, rrollcat e të gjitha shtazët dëmtuese : gjarprin mos ti nxajë, lepurin mos t'u hajë loknat e bathën, e shpendin emën për emën e krimbat e tokës mos t'u mbajnë dam ndër ara. Tri ditë përpara veravet duhet me mshefë shoshat, sitat, furkat e me çartë krojet, në mënyrë që mos me i pamë këto sende asnjë rob i shtëpisë, pse për ndryshej nul lidhet gja. Këto ditët e veravet bijnë gjithmonë ndër ditët e para të marsit. Mbas darkë, të gjithë pjesëtarët e shtëpisë bashkohen rreth zjarrit. I zoti i shtëpisë merr një pe të zi leshe, e lidhë për vergue një nyje e thotë këto fjalë. Lidhe Zot nata e mojt e dita e verave ! Unë pak e Zoti shumë ! Po lidhim shtrigat. Kështu përsërit këtë veprim për secilin shpirt damtues, sëmundje, krimba e kodra që don me lidhë".

Po në Verilindje si festohet "Dita e Verës" ? Hapat e para të femirisë i kam kaluar në vendilindjen time Dibër, ku e kam përjetuar drejtpërsëdrejti dhe kam qenë dëshmitarë se si Dibranët e festojnë "Ditën e Verës". Prandaj po përshkruaj pikërisht trevën e Dibrës, duke e simbolizuar me pozicion gjeografik Veri-Lindje, pasi edhe zonat përreth në shumë elemente festojnë dhe kanë shumë ngjashmëri me dibranët.

Festimet e kësaj ditë në Dibër fillojnë

dy javë përpara, ku djemtë e rinj gjatë ditës shkojnë në mal dhe presin dëllinja, të cilat i sjellin në fshat, për të formuar një ose më shumë mullarë. Këta mullarë me dëllinja vendosen kryesisht në pika më të larta të fshatit, në mënyrë që zjarri të jetë sa më i lartë duke u bërë konkurrencë të dukshme fshatrave të tjerë për rreth.

Kur, Dielli ulet dal nga dal nga horizonti duke u zëvendësuar nga hëna, të rinjtë afrohen rreth mullarëve të dëllinjave,

livadh ose në qendër të fshatit, ku përveç këtyre riteve bëhen edhe mjaft lorja të tjera si : "Kala Dibrane", mundje mes djemve të rinj e etj. Gjatë paradites nënat përgatisin drekën e bollshme, ku një vend të veçantë zë flija (gatim tradicional kryesisht i zonës së Dibrës).

Pas drekës, njerëzit dalin për vizita tek të afërmit.

Kështu mbyllet festimi i Ditës Verës, si një festë që sjell vetëm gëzim, harmoni dhe lumturi në familjet tona.

gjelbërimin. Ndërsa sot është fiksuar 14 marsi, dite e festes se lashte, që shënon ndryshe fundin e dimrit te acarte dhe hyrjen e pranverës se çeljes se luleve. Në kohën antike, te paret tanë, Iliret, udhëtonin nga te kater anët për t'ju falur perëndisë së ripërtëritjes dhe gjithësisë, Diana Candieviensis. Dita e Verës është feste e te gjithëve, e te pasurve dhe te varfërve, është feste mbarëpopullore ku te gjithë gëzojnë. As feja, as ideologjia dhe së fundi as politika, nuk mundën ta

kenë të tyre. Kohet shkuan dhe tempulli i festes qëndroi në Elbasan, në qytetin e luleve dhe këngës, te dashurisë dhe begatisë. Duhet theksuar dhe një herë që dt. 14 marsi thjesht hap festivalin njëjavor të pjellorisë dhe rilindjes së natyrës, duke çuar drejt 21 marsit, që është Dita Kalendarike diellore e Verës. 14 marsi është Dita e Verës për Shkumbinin dhe, për shumë vjet me radhë dhe, Tiranën, por krahinat e tjera shqiptare kanë secila Ditë të tyre të Verës brenda kësaj jave që mbahet në formë festivali në gjithë trojet. Vjet p. sh. qyteti i Shkodrës festonte në dt. 15 mars. Caktimi i datës kryhet krejt nga ana praktike duke marrë parasysh ditën më të qëndrueshme me diell brenda kësaj jave për secilën kra-

hinë. N.q.s. vihet re në krahinat e Shqipërisë së Mesme, 14 marsi ka qenë gjithnjë ditë me diell dhe e ngrohtë, ndërsa ditët e mëpasme shpesh janë me re dhe madje dhe shi.

Duke synuar një ditë të tillë, secila krahinë në bazë të nën klimës së vet cakton një datë me ditën më të qëndrueshme të diellit, brenda kësaj jave. Data mund të puqet dhe me një a më shumë krahinat të tjera, por gjithnjë në vartësi të anës praktike dhe nuk është e thënë që secila krahinë të ketë doemos datën e vet. Është klima vendore që ka fjalën e fundit dhe për këtë është e nevojshme njohja e zonës, pasi festimi është organik dhe jo artificial. Për këtë arsye dhe mënyra e festimit ndryshon sipas krahinave, gjë që i jep dhe bukurinë e vet festivalit në rang kombëtar.

Një sqarim tjetër që shpeshherë është i nevojshëm. Pse dita quhet e Verës, kur në fakt festivali është pranveror ? Kjo ndodh sepse në kalendarin diellor ilir/shqiptar (dhe të disa popujve të tjerë), ka vetëm dy stinë, Verë dhe Dimër, dhe stinët nisin me barasnetët (ekuinoqset) në mars e shtator dhe arrijnë mesin me solsticet në qershor e dhjetor, atëherë kur festohet përkatësisht Mesvera dhe Mesdimri.

PERGATITI
LULASH BRIGJA



dhe presin momentin që ti vënë zjarrin. Sapo zjarri ndizet, djemtë gjuajnë me bahe (është mjet i trashëguar brez pas brezi dhe që bëhet në mënyrë artizanale, e cila hedh prej një distance relativisht të largët gurë që kanë përmasa mesatare) për të larguar dhe vvarë të keqen, në mënyrë që pranvera të jetë më reshje të bollshme, për siguruar të korra të mira me shumë "beregat", nga të cilat do të krijohen rezerva të bollshme për të kaluar periudhën e gjatë të dimrit. Kurse, vajzat këndojnë rapsodi të trashëguara dhe të transmetuara brez pas brezi që i kushtohen "Ditës së Verës". Ky ritual vazhdon deri me datë "14 mars".

Me "14 mars" në mëngjes vendoset një garë e pashpallur kush zgjohet më shpejt në mëngjes (sipas traditës ai që zgjohet më vonë do ti shkoj i gjithë viti në të shumtë në kohës në gjumë), familjet që zgjohen më vonë zakonisht kanë edhe një ndëshkim simbolik, ju mbyllet nga jashtë dera e shtëpisë.

Pasi zgjohen, të rinjtë dalin për te mbledhur lule si kukreka, lulethane, shëlgje etj, të cilat i vënë mbi portën hyrëse si dhe brenda shtëpisë. Kurse vajzat ziejnë vezët, dhe i ngjyrosin me mozaikun e ngjyrave. Vezët rroken mes të rinjve me fitimas (që do të thotë se ai që ka vezën më të fortë ja fiton dhe ja merr ati që i thyhet).

Këto ngjarje ndodhin zakonisht në një

MIRASH BINOSHI, RREZATUNIA KULTURË DHE MIRËSI

Duke u kthyer mbrapa në kohë dhe kujton ata që vite më parë janë larguar prej nesh, por që kujtimet e tyre duket sikur i kemi pranë. Kjo të kujton malet që të duken më qartë kur je në distncësi prej tyre, të duken më mirë madhështia dhe bukuritë e tij natyrore sa që të shtojnë dëshirën për ta parë. Kështu ngjan me ata që janë ndarë nga ne, siç është rasti i shokut dhe mikut tonë Mirash Binoshi. Ai është lindur në fshatin Lotaj të Shalës, në vitin 1933, në një familje fisnike tradicionalisht.

Detyra e tij ishte sa ushtarake aq edhe publike civile, të cilat i kreu me nder e dinjitet. Detyra e tij kishte të bënte me popullin sepse në atë kohë ne ishim popull-ushtar me shumë struktura të mirëorganizuar. Në këtë drejtim rol parësor luante dega ushtarake, në organizimin dhe plotësimit e organikave dhe ndjekjen e tyre në terren. Mirash Binoshi që shembull në plotësimin e detyrave që kishte marrë përsipër. Mirash Binoshi ishte personalitet i njohur dhe shumë i respektuar nga kuadrot ushtarake, nga populli i thjeshtë, por edhe nga eprorët e tij.

Ai ishte njeri i thjeshtë, i dashur me njerëzit, ruante lidhje të përhershme me vendlindjen dhe shkonte shpesh në shtëpinë e të parëve të tij e kudo në Dukagjin, për të takuar të afërmit, shokë e miq, për tu ç'madh me vendlindjen, për të cilën pati respekt dhe nostalgji deri në fund të jetës.

Prindërit i mbajti gjithnjë pranë vetes. Mirashi kishte dajat në shtëpinë e Mark e Gjon Hasanit në Pecaj të Shalës, familje me tradita të hershme atdhetare.

Ai ishte njeri i emancipuar në familjen e tij, respektonte bashkëshorten Bute dhe gjithë pjestarët e familjes me shumë kënaqësi. Ata kishin dhe gjenin te Mirashi njeriun e mençur dhe këshilluesin

më të mirë. Ishte shembulli i një qytetari të kohës, ishte integruar shumë mirë në vendin ku jetonte me edukatën qytetare.



Ishte kënaqësi shumë e madhe të qëndroje, në kohën e lirë, me Mirash Binoshin. Ai që shumë i pranueshëm në shoqëri dhe pa ndjenjën e njeriut të zyrës, apo karriges në nivel të lart që ai ishte.

Në vitin 1941, me hapjen e shkollës për herë të parë në Lotaj, Mirashi ishte njëri ndër 9 nxënësit e parë në këtë shkollë nga fshati Lotaj. Shkollën e filloj para mbarimit të luftës dhe e mbaroj pas luftës, në vitin 1946. Shkolla fillore ishte në Kodër të Shëngjergjit. Mësoi mjaftë mirë dhe u bë një njeri me vlera që i shfaqti vazhdimisht që në fillim dhe i vazhdoi deri në fund të jetës së tij.

Mirashi mori pjesë në aksionet e para

për rindërtimin dhe ndërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta. Në vitin 1947 merr pjesë, vullnetarisht, për tre muaj në

ndërtimin e hekurudhës Durrës-Tiranë, krahas shumë djemëve dhe vajzave nga Dukagjini, midis të cilëve edhe Linë Zef Hili e cila dha jetën në krye të detyrës. Mirashi ishte njëri ndër ata që e sollën në shtëpi për të bërë varrimin e saj, dhe menjëherë u kthye për të vazhduar aksionin.

Në vitin 1950 Mirashi u caktua nga seksioni i arsimit të rrethit Dukagjin drejtues kursit kundër analfabetizmit në Lotaj. Puna e tij ishte vullnetare, sepse punonte ne postëtelegrafën në Kodër të Shëngjergjit në të cilën punoj deri në fund të vitit 1951. Në vitin 1952 emrohet mësues në shkollën fillore Gimaj në të cilën qëndroi deri në

vitin 1953, kohë, kjo, kur u thirrë për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, por për të plotësuar nevojat e kohës, menjëherë pas betimit ushtarak u dërgua në shkollën e oficerëve të kohës, në të cilën qëndroi 2 vjet. Me mbarimin e kësaj shkollë gradohet nëntoger dhe emërohet në drejtimin e grupit të artillerisë në Reç të Mbishkodrës. Me kalimin e kohës, vlerësohet duke u ngjitur në grada ushtarake, deri kapiten i parë. Pastaj, me heqjen e gradave në vitin 1966, emërohet komandant batalioni, detyrë të cilën e kreu me shumë sukses. Është dekoruar disa herë për punën e mirë në shërbim të atdheut. Ka shërbyer pranë komandës së korpusit të Shkodrës për disa vite, prej nga ku kaloi në detyrën e zv/kryetarit të Degës Ushtarake të Shkodrës, dhe pas dy vitesh Kryetar i saj deri në daljen e tij në pension.

Shkruam pak fjalë rreth kujtimeve për bashkëmoshatarin, mikun dhe shokun tonë Mirash Binoshi. Ai meriton shumë më shumë, për vlerat e tij në të gjitha drejtimet, e që duhet vlerësuar në të ardhmen, sepse njerëz të tillë nuk duhet lënë në harresë nga të gjithë ata që i njohin, qofshin familjarë apo bashkëpunor, shokë e miq. Të tillë persona kanë vlera jo vetëm për familjen, por për të gjithë komunitetin, bashkëpunorët, krahinën dhe vendin. Vlerat nuk duhet të zbehen, nuk duhet harruar, nuk duhet lënë në njëanë.

Respektin ua kemi borxh të gjithë atyre që na bëjnë krenar në çdo rast, kudo që kanë punuar dhe jetuar.

Edhe pse është ndarë nga jeta në vitin 2001, pra që prej 15 vitesh, dhe koha do të vazhdojë të kalojë, por, ajo nuk do ta kenë mundësinë që të fshijë kujtimin dhe respektin për mikun dhe shokun tonë Mirash Binoshi.

Pjetër Delia, Zef Sokoli

FAKTE SHKENCORE QË DO JU MAHNISIN

1. Ka mjaftueshëm ADN në trupin e njeriut sa në qoftë se do e zgjasim në një vijë të drejtë do mjaftone për të bërë rrugën nga dielli tek plutoni 17 herë vajtje ardhje.
2. Mesatarisht në trupi i njeriut përmban 10 herë më shumë qeliza bakteriale se sa qeliza të vetë trupit.
3. Një fotoni i duhen 40.000 vjet për të udhëtuar nga qendra e diellit në sipërfaqen e tij, por vetëm 8 minuta për të arritur nga dielli në tokë.
4. Në një shtrirje prej 2000 kilometrash barriera e madhe koralore në Australi është struktura biologjike më e madhe në tokë që mbart jetë.
5. Ka 8 herë më shumë atome në një lugë çaji me ujë se sa ka pika uji në oqeanin Atlantik.
6. Mesatarisht një person udhëton në këmbë gjatë të gjithë jetës së tij aq sa do mjaftonte t'i binte rrotull botës 5 herë.
7. Kur heliumi ftohet shumë pranë zeros absolute (-273.15 °C) që është temperatura më e ulët e mundur ai kthehet në lëng dhe fiton disa aftësi shumë të çuditshme, ai rrjedh në drejtim të kundërt me gravitetin. Nëse vendose brenda një gote ai do të dilte nga gota duke u ngjitur në faqet e saj të brendshme.
8. Nëse ylli me emrin Betelgeuse i cili është një gjigand i kuq do të shpërthente në një supernova atëherë qielli jonë i natës do të ndriçonte për një periudhë prej 2 muajsh. Kjo ngjarje mund të ndodhë në cdo kohë si pas disa mijëra vitesh, nesër apo qoftë edhe tani.
9. Një rruaze të kuqe të gjakut i duhen 60 sekonda për të bërë një xhiro të plotë brenda trupit të njeriut.
10. Universi i njohur përbëhet nga 50.000.000.000 galaktika. Ekzistojnë afërsisht nga 100.000.000.000 në 1.000.000.000.000 yje në secilën galaktikë. Vetëm në galaktikën tonë rruga e qumshtit mund të ekzistojnë deri në 100.000.000 planete. Akoma mendoni që jemi vetëm?

Mblodhi L. Shyti

FOLKU BASHKON HAPËSIRAT SHQIPTARE, NË ULQIN

ARTI, PËRKATËSISHT KULTURA BËN INTEGRIMIN SHPIRTËROR TË KOMBIT TONË

Para pak ditësh në qytetin e lashtë të Ulqinit, në shtëpinë e traditës, në një festë mbarshqiptare, Shoqëria Artistike "Tradita" vendosi të festojë, të gjithë së bashku, me koncertin "Premierë", me rastin e 3 vjetorit të themelimit të saj, aktivitet që u zhvillua në qendrën kulturore të qytetit. Spektakli i dhuruar nga artistët në skenë dhe pritja e ngrohtë e publikut, e sfiduan atë natë të ftohtë shkurti, sepse këngët dhe vallet sollën pranverën e këngëve dhe valleve shqiptare.

Në këtë festë të madhe që ngjasonte si një festival, me pjesëmarrjen e katër ansambleve folklorike nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, të cilët u bënë bashkë në një mbrëmje të madhe folku. Në sallën e tejmbushur e të mrekulueshme ishin vallet që na vinin plot freski nga Ansambli "Dëshmorët e Kombit" nga Obiliqi-Kosovë, "Ilirida" nga Shkupi, "Bilbili" nga Vlora si dhe "Tradita" e Ulqinit.

Organizatore e këtij manifestimi të veçantë kulturor ishte Shoqëria Artistike "Tradita" me mbështetjen e komunës së Ulqinit dhe donatorë të tjerë nga biznesi. Ky organizim ishte konceptuar edhe si një përkushtim për 8 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, duke dhuruar një spektakël të vërtetë, ku u shpalosen vlerat më të mira të folklorit mbarëkombëtar.

Kënga 200 vjeçare e "Gjergjefit" kënduar nga Egzona Salaj, fituese e çmimit të parë në Festivalin Kombëtar të Gjyokastrës, maj 2015, përcolli emocion dhe interesim të jashtëzakonshëm nga të pranishmit. Emosione sollën edhe këngëtarët ulqinakë Gëzim Salaj, Suad Mehmeti dhe Edmir Lika.

Prezenca e grupit folklorik "Bilbili", dhe valltarët me fustanellën e bardhë tradicionale, me polifoninë e rrallë por edhe me vallet e Jugut e Çamërisë, do konsideroheshin nga publiku si e veçanta dhe befasia e koncertit.

Sipas organizatorëve për të parën herë në skenën e Ulqinit do kishte rastin të ngjitej një grup nga Labëria dhe kënga me iso të dëgjohej drejtpërdrejtë.

Tashmë ky grup është pjesë e trashëgimisë kulturore botërore e regjistruar si kryevepër e trashëgimisë folklorike nga Unesko.

Pas suksesit të spektaklit, e në mënyrë të veçantë, pas mbresave të jashtëzakonshme që la grupi "Bilbili" erdhin natyrshëm edhe një intervistë me drejtuesin e këtij grupi z. Sejmen Gjokoli, i cili i emocionuar dhe i befashuar nga mikpritja, si dhe sukcesi që pati grupi i tij tha:

"Ulqini përmes këngës e valles shqipe, krijesës më të bukur shpirtërore të po-

pullit shqiptar, i mblodhi trevat kudo që janë, i mblodhi bashkë folklori, kjo pasuri e madhe shpirtërore, që na bën kurdoherë krenar si Komb kudo që jemi.

Më duhet që edhe një herë të falenderoj publikisht ideatorët, organizatorët dhe mbështetësit e këtij manifestimi shpirtëror mbresëlënës, stafin e shoqërisë artistike "Tradita" dhe posaçërisht të pa lodhurit Selatin Gjeloši, kryetar i shoqërisë; Dini Zeneli, menaxher; Shefqet Luca, udhëheqës artistik; Gazmend Kovaçi, skenarist etj të cilët realizuan një aktivitet, sa të bukur po aq dhe kuptimplotë.

Mirënjohje edhe për Kabil Kurtin biznesmenin e njohur ulqinak, i cili në emër të donatorëve të këtij aktiviteti, me plot dashuri, garanto mbështetje për vazhdimësi e projekte të tjera të kësaj shoqërie kulturore edhe në të ardhmen.

Shoqëria Kulturore "Tradita" është e vendosur të kontribuojë me sa të mundet në ruajtjen e traditës dhe vlerave tona kulturore e shpirtërore".

Valltari i Ansambli të Këngëve dhe Valleve Popullore "Ilirida" i Shkupit Ilir Loku, u tregua i gatshëm të më jepte opinionin e tij për këtë aktivitet madhështor: "Kam dëshirë të them shumë fjalë, por e kam të vështirë, sepse më lehtë e kam të shprehem me interpretimet e mia në vallet e bukura shiptare. Në fillim doja të përgëzoja organizatorët për këtë iniciativë



që kanë ndërmarrë, për kalimin e SHKA në Ansambli të Këngëve dhe Valleve me emrin domethënës "Tradita" dhe njëkohësisht doja të uroj edhe 8 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës.

Përshtypjet e mia ndaj këtij koncerti janë të papërshtypshme. Një pritje vllazërore siç na ka hije neve shqiptarëve kudo që jemi. Bashkimi i 4 ansambleve në një skenë është fuqi kulturore. Këngë e valle të trevave të ndryshme kombëtare që tingëllojnë tamam shqip bënë që edhe valltarët me publikun të ndiheshin të emocionuar e të gëzuar për festë.

Mund të them që akomodimi i ansambleve ishte përzgjedhja shumë e bukur, bregu detit, pranë kalasë së Ulqinit.

Ajo që më la më shumë përshtypje ishte skenari. Një skenar që më la shumë mbresa që nga fillimi e deri në mbarim, në paraqitjen përshëndetëse të të gjithë ansambleve.

Prezantueset e çdo ansambli u bashkuan dhe bënë hapjen e programit të ansambleve të tyre me kostumet e tyre të larmishme. Më madhështore ishte momenti kur të gjithë artistët dolën në skenë dhe këndonin e vallzonin bashkë për Kosovën.

Unë nga eksperiencia ime si valltar kam parë shumë manifestime tradicionale, qofshin ato festivale apo koncerte, mirëpo nga ky koncert kam mësuar shumë gjëra reth organizimit.

Një publik artdashës i cili pa ndërprerje mbështeti artistët me duartrokitjet e tyre të cilët na dhanë vullnet të fluturojm aty në skenë.

Ndarja e mirënjohjeve dhe shkëmbimi i dhuratave ndërmjet ansambleve ishte mesazhi që përcollëm tek artdashësit tek institucionet, bashkimi bën fuqi. Ne u bashkuam kënduam e festuam ashtu siç na ka hije. E them me gjithmend, arma më e fortë e një populli është kultura. Mënyra më e mirë për t'u treguar se kush jemi, çka kemi dhe sa kemi traditë e kulturë.



Sipas Drejtorit të Kulturës Dr.Nail Draga, me të cilin mundëm të takoheshim ndër të tjera tregoi: „Kurrë më parë salla e shfaqjeve nuk ka patur një publik të tillë dhe si asnjë herë tjetër një interesim kaq të madh. Ishte ky një program i rrallë për qytetin e Ulqinit, nga fakti se me tepër i ngjante një festivali se sa një programi të zakonshëm artistik. Pjesëmarrja e katër ansambleve artistike në këtë mbremje kishte diçka të veçantë se për të parën herë në Ulqin është interpretuar kënga polifonike labe, që u mirëprit nga publiku. Dhe s'ka si të jetë ndryshe, sepse në

ketë program ishin të përfaqësuara pothuaj të gjitha krahinat entografike shqiptare. Është arti, përkatësisht kultura që bën integrimin shpirtëror të kombit tonë. Uroj që një mbrëmje e tillë të bëhet tradicionale, sepse Ulqini e meriton një veprimtari të tillë kulturore“.

Prezenca në sallë e ambasadores amerikane në Malin e Zi, por edhe ambasadorit shqiptar si dhe personalitetëve të tjerë ulqinakë, e shtuan edhe më shumë solemnitetin e aktivitetit.

Në fund të koncertit Kryetari i Shoqërisë „Tradita“ Selatin Gjeloši, deklaroi: „Kjo datë e rëndësishme shënon dhe shndërrimin e Shoqërisë në Ansambli „Tradita“, i cili do të çojë më tej sukseset e shoqërisë që tanimë ka një historik të mbushur me suksese. Pjesëmarrja e saj në veprimtari kulturore-artistike, jo vetëm në Ulqin, por edhe në Shqipëri, Kosovë, e deri në Amerikën e largët, e rritën profesionalisht dhe kështu lindi nevoja e shndërrimit në Ansambël, si format që do të jetë më pranë pasqyimit të vlerave tradicionale të popullit tonë“.

Një fakt emocionues ishte se pas përfundimit me sukses të aktivitetit, spektatori nuk largohej nga salla. Dukej sikur ato po prisnin që të fillonte koncerti. Duartrokitjet, biseda mes miqsh, takime me artistët, foto dhe selfie e mbajtën sallën të populluar për shumë kohë.

Pas koncertit u mbajt edhe një kokte-

jl ku u shpërndanë edhe mirënjohje për kontributin e artistëve nga trevat e ndryshme shqiptare për mbajtjen gjallë dhe kultivimin e vlerave të folklorit shqiptar. Me këtë rast një çmim mirënjohje iu dha edhe televizionit „Teuta“ për mbështetjen mediatike që i ka dhënë në vite kësaj shoqërie, sot Ansambli „Tradita“, i cili do të çojë më tej këtë traditë.

Ramazan ÇEKA,
Shkurt 2016

DASMA N'TUZ KA KRUSHK TE PAR DEDE GJO' LULI FLAMURTAR

Me rastin e 105 vjetorit, vitit jubile të kryengritjes së Malësisë, kur me 6 prill 1911, një çetë trimash të udhëhequr nga Dedë Gjo' Luli, me betejën e tyre në Deçiç u bënë prologu i kryengritjes së përgjithshme antiturke për pavarësi, në Tuz, një qytet i vogël pranë këtij vendi historik, Shoqata Kulturore Artistike "Dedë Gjo' Luli", organizoi një aktivitet të pasur, thellësisht kombëtar me një pjesëmarrje të gjërë popullore, por edhe me të ftuar nga të gjitha trevat shqiptare e më gjërë.

Ky aktivitet, i cili do të transmetonte mesazhet e tij u zhvillua në sallën e kulturës të kësaj qendre të vogël shqiptare. Përveç evokimit të ngjarjes historike, organizatorët kishin sjellë aty për të shfaqur një film dokumentaro-artistik "Dasma malësore", që me një realizim brilant, solli para të pranishmëve vlerat e mëdha të trashëgimisë sonë kulturore, zakonore, etnografike e muzikore.

Skenaristi dhe regjisori i këtij dokumentari ishte vetë kryetari i kësaj shoqate, një ndër patriotët më të shquar të kësaj zone z. Gjon Dushaj.

Ai solli në këtë eveniment një realizim historiko-artistik që ia vlen të përcillet nga brezat e të rinjtë që lindin në këto troje, si një shërbim i vyer për kulturën tonë kombëtare në fushën e trashëgimisë zakonore.

Ky ishte një aktivitet i veçantë përkujtimor ku, përmes fjalës, u evokua akti i madh i Dedë Gjo' Lulit dhe roli historik i tij në fillimet e shekullit të kaluar, që u pasua nga një përshëndetje shumë vëllezërore, e pritur ngrohtësisht nga malësorët tuzjanë pjesëmarrës në këtë takim.

Më pas e morën fjalën dhe përshëndetën shumë nga të pranishmit dhe uruan nga zemra për gjithçka që po bëhej asaj ane për mbajtjen gjallë të historisë, traditave dhe shqiptarizmit.

Gjon Dushaj, Kryetar i Shoqatës Kulturore Artistike "Dedë Gjo' Luli" të Tuzit tha se: "qëllimi i aktiviteteve tona është që t'i bashkojmë vëllezërit tanë kudo që janë, qoftë në Shqipëri, Kosovë, Çamëri, Maqedoni apo edhe në Amerikën e largët dhe vendet tjera anëkund rruzullit tokësor, ashtu siç kishte vepruar Dedë Gjo Luli, i cili kishte shkrire familjen dhe pasurinë e tij, për bashkimin e trojeve shqiptare dhe çlirimin nga zgjedha shumë shekullore turke". Sipas Dushajt, dokumentari i shfaqur në përvjetorin e ngritjes së Flamurit Kombëtar në Deçiç, i cili më pas ishte ngritur edhe në Vlorën historike, kishte për motiv përkujtimin e kësaj ngjarjeje të shënuar dhe transmetimin e vlerave të mëdha historike, traditës e kulturës malësore e shqiptare tek brezat e ri.

Organizimi i këtij përvjetori nga shoqata kulturore artistike që mban emrin e kryetrit "Dedë Gjo' Luli", i kushtohej traditave shqiptare. Sipas organizatorëve të këtij manifestimi kulturor, tema e trajtuar për traditën e organizimit të das-

mave malësore, kishte për qëllim sensibilizimin mbarëkombëtar për ruajtjen e vlerave dhe traditave shqiptare.

Rruga për realizimin e këtij dokumentari në këtë përvjetor, edhe pse kishte qenë e gjatë, kishte gjetur mikpritjen dhe dashurinë vëllezërore të vendasve malësorë të Tuzit dhe fshatrave të Malësisë.

"Mirë se erdhët vëllezër, qofshi faqebardhë që na nderuat me ardhjen tuaj në truallin e Dedë Gjo' Lulit", ishin fjalët mikpritëse të njerëzve që takonim rrugëve apo lokaleve, të cilët mezi prisnin të ofronin bujarinë e tyre sipas traditave shqiptare.

Ishte i papërkujtuar gëzimi që po takonin vëllezërit e tyre nga Vlora e Gjilani, Tirana e Deçani, Shkodra e Klina, Prishtina e Tropoja dhe Diaspora.

Simon Camaj, në fjalën e tij tregoi se banorët e kësaj treve në vazhdimësi po shpërngulen dhe po marrin rrugën për shtetet perëndimore, kryesisht në Amerikë. Çdo ditë e më shumë po zvogëlohen si popull, fshatrat po boshatisen, të rinjtë po ikin nga trojet

qëllimin e shfaqjes së dokumentarit "Dasma malësore", në këtë ditë përkujtimore kur Dedë Gjo' Luli kishte ngritur flamurin kombëtar, tha se: "traditat shqiptare, jo vetëm të organizimit të dasmave, por edhe të evenimenteve të tjera, janë duke humbur në vazhdimësi, duke u bërë me evropianë se evropianët apo edhe me amerikanë se amerikanët. Motivi i shfaqjes së dokumentarit është që t'ua rikujtojmë gjeneratave të reja, si në Malësi, Ulqin, Kosovë e Shqipëri dhe kudo që frymon gjak shqiptari, se traditat shekullore të shqiptarëve, duhen ruajtur dhe kultivuar, krahas zhvillimeve demokratike dhe teknologjise bashkëkohore".

Gjithnjë në vendet e duhura dhe shumë aktiv për të respektuar datat e lavdishme promovuese dhe përkujtimore, përshëndeti "bacaloku", Presidenti i Unionit Artistik të Kombit Shqiptar z. Azgan Haklaj, i cili para se të nisej nga Tirana, kishte shkuar tek shtatorja e Dedë Gjo' Lulit, si për t'i marrë amanetin e për ta përcjellë në Tuz përshëndetjen e

disa shekujsh robërie. Lavdi veprës tuaj të pavdekshme! Kombi Shqiptar veprën tuaj e ka shndërruar në refren kenge: "Kruja e dytë, Vlora e parë, Dedë Gjo Luli flamurtar".

Më tej ai tha se nuk ka qetësi në Ballkan pa bashkim të trojeve shqiptare, ndaj edhe moto e tij ishte, "një komb-një shtet". Për shqiptarët po vijnë ditë të bardha, po vjen koha e shqiptarëve, kur dihet se Kosova ka fituar pavarësinë e saj si shtet dhe po ecën në rrugën e integritimit, ndërsa Shqipëria përveç se është bërë anëtare e NATO-s, po ecën në rrugën e duhur, për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian.

Prof. Dr. Sabri Kadriu u shpreh se ditë më të mira po vijnë për shqiptarët, pasi kemi marrë rrugën e duhur të zhvillimeve dhe integritimit, të mbështetur nga vendet mike, të cilave iu prin SHBA-ja, me bekimin e zotit.

Sejmen Gjokoli, i cili kishte udhëtuar nga qyteti bregdetar i Vlorës, nuk kishte se si të mos kujtonte përcaktimin e rrallë që Ismail Qemali i ka bërë këtij udhëheqësi popullor legjendar të Malësisë së mbi Shkodrës: "Dedë Gjo' Luli- pushkë e ngrehur për Shqipërinë".

Z. Gjokoli vlerësoi punën e palodhur të antarëve të shoqatës "Dedë Gjo' Luli" për realizimin interesant dhe plot profesionalizëm në evokimin e traditës, zakoneve e dokeve të Malësisë së kësaj treve dhe njëkohësisht u ndal me tone shumë vlerësuese tek puna e jashtëzakonshme dhe unikale që ka bërë artisti malësor, Shtjefën Ivezaj, i denjë për të shkruar emrin e tij në rekordet "Ginnes" për grumbullimin, ruajtjen dhe propagandimin e kulturës materiale e shpirtërore të Malësisë e më gjërë.

Z. Gjokoli bëri të ditur se tani që po afron maji, po troket edhe Edicioni i 8-të i "Aulona Inter Folk Festival", i cili ashtu sikur në vitin e kaluar, do marrin pjesë shoqëri dhe individë nga të gjitha trojet ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët.

Gazetari nga Kosova Adem Lushaj, pasi bëri një pasqyrim dhe vlerësim të hollësishtëm të këtij aktiviteti, diskutimin e tij e mbylli me një pjesë të komentuar nga një fjalim dhe dëshirë e presidenti dr. Ibrahim Rugova, i cili kishte synim ndërtimin e rrugës që do lidhte Kosovën me trojet shqiptare të Malit të Zi, që përmes Deçanit dhe Plavës, të lidhej me Ulqinin dhe vendet tjera të kësaj treve.

Banorët e Tuzit na përcollën në përfundim të aktivitetit me urimin e bashkimit sa më të shpejtë të trojeve shqiptare, amanet i lënë nga Dedë Gjo' Luli dhe të gjithë patriotët shqiptarë.

"U takofshim sa më shpejt dhe sa më shpesh!" ishte lamtumira e dhënë nga organizatorët bujarë të këtij aktiviteti, për të mbajtur gjithmonë gjallë traditën e Malësorëve, por edhe të gjithë kombit shqiptar.

Përgati Ramazan Çeka, Prill 2016



stërgjyshore dhe kjo për ne, por edhe për gjithë trojet shqiptare nuk është asgjë e mirë, sepse kështu nuk braktisen vetëm trojet, por çdo që na kanë lënë të parët.

Prof. Nikollë Berisha, duke shpjeguar

tij me plot emocione ndër të tjera ai tha: "Sot është dita jote Dedë Gjo' Luli! 105 vjet me parë ju kurorëzuar kryengritjen e Malësisë me ngritjen e Flamurit të Gjergj Kastriotit (Skenderbeut) në Deçiç, pas

Kadare në dritën e një “qyteti...”

NË NDERIM TË 80-VJETORIT TË LINDJES SË ISMAIL KADARESË



Duke shtegtuar në të parin roman të Kadaresë “Qyteti pa reklama” gjendesh përpara një befasi tepër të këndëshme: Mes nesh, për herë të parë, i plotë, në realitetin shqiptar të “republikës së letrave shqipe”, i pari roman i Kadaresë “Qyteti pa reklama”, pas një izolimi dhe “imigrimi” disadekadash në kushtet e realsocializmit dhe so-crealizmit shqiptar për t’u bërë,

tashmë, pjesë e shëndetshme e universit kadarejan, në mijëvjeçarin e ri.

Autori e quan “Qytet pa reklama” krijesën e vet të parë, në llojin e gjatë të prozës, ndoshta sa si rebelim ndaj asaj mjegullnaje plot vrug të një letërsie “dritë shterpe, ndriçim zhveshur, e llogaritur për t’i shërbyer një teze, një kohe, një dreqi e di çfarë”, a si kushtrim i fuqishëm moderniteti përballë përdhosjes ideologjike, që po i bëhej këtij tempulli të shenjtë, siç është ky i artit, në hullitë e kursit zhdanovian, shijen e hidhur të të cilit po aq, sa do ta parandjente nga leximi në moshën 14-15 vjeçare të romanit “Nëna” të Gorkit, po aq do ta “shijonte” si dëshmitar okular i zhvillimit të “këtyre shijeve” si student që ndiqte me aq pasion letërsinë pranë institutit moskovit “Gorki” në ish-Bashkimin Sovjetik.

Ndonëse e gjithë vepra përshkohet nga tharmi modernist, tepër spikant, mbështetur mbi një fabul të reduktuar, kurrsesi shtrat Prokusti, në linjën e saj subjektore, ajo gjithsesi është farë e ndritshme, plot jetë, e qartë dhe e thjeshtë, siç mund të jetë një vepër e shëndetshme, ndryshe si vepër sfidë ndaj një kursi-krize po kaq të vërtetë, që mjerisht, si një ndërprerje e dhimbshme, qe fati i letërsisë sonë të Pasçlirimit, e shprehur në kodin krijues të Kadaresë si kod i një “Qyteti pa reklama”.

Ky roman, si përjetim artistik dhe si sfidë ndaj realizmit socialist, veçanërisht në vendin tonë, po të kujtojmë se në BRSS jo pasardhësit e tij, por as Stalini nuk do të prekte shenjtërinë e panteonit rus të shekullit XIX me: Pushkinin, Gogolin, Tolstoin, Nekrasovin, Çernishkevskin, Çehovin, Dostojevskin etj., vjen sfida më kuptimplote e atij eksperimenti të ri, që si metastazat, po shtrihej vullshëm në realitetin shqiptar të viteve 50-të. Jo rastësisht, mjeshtri i fjalës si filozofi estetike, kritiku letrar, Mitrush Kuteli, do të shprehej në vitet “40-të:” Terreni i letërsisë është një tokë ku gëlojnë gjarpërinjtë; të vrasin shokët, se u bën hije”. Mrekullia e Kadaresë së ri shpaloset në nuhatjen intuitive artistike të denoncimit, në mënyrën e vet, të këtij rreziku që do të shterpësonte vlerash të vërteta krijimtarinë e disa dekadave të të ashtuquajturit realizëm socialist.

Vepra mbështetet mbi një fabul të reduktuar dhe “intrigë” subjektore jo të zakonshme duke u shquar për një tharm modernist mjaft brilant në kuptimin më të plotë të këtij nocioni. Le të lexojmë “së brendshmi”, më konkretisht, ku qëndron moderniteti i këtij epi modern, kur Kadare i ri mund të themi, pa gabuar, ishte ende nën “kurthin e ëndrrës” si shumë prej nesh, që Bernard Shou, nobelist, do ta quante normale për një 23 vjeçar, çka shprehet mjaft bukur në nënvizimin e autorit: “Ai ishte fatkeq. Ai ishte edhe më fatkeq, ngaqë e dinte këtë”, duke iu referuar kështu personazhit kryesor të romanit, Gjon Kurtit, ndryshe zëri i instinktit të krijuesit. Kalimi në “laboratorin” e krijuesit, rregjistrimi në “kalendarin e dytë” të tij, të një vepre të tillë si “Qyteti pa reklama”, në rrethanat që dihen dhe aq sa mund të nënkuptohen falë imoralitetit, deri institucional letrar-artistik të atyre viteve e mjerisht disa dekadash, nuk ishte tjetër veçse një “joshje e përhershme drejt zonave të ftohta të padashura, madje, disi të frikshme, për të mos thënë skëterrë, veti e racës sonë demoniake” nga ana e Kadaresë si artist me një prirje të natyrshme

drejt botës së “izmave”. Modernitetin e kësaj vepre lexuesi e ndjen që në titullin e saj. Autori fare lehtë mund ta quante “Qytet kështjellë”, apo “Qytet kuçedër”, që i shkonte aq për shtat dekorit folklorik, apo mitologjik, kur simbolika tradicionale në të tillë tituj, apo referenca e gjente plotësisht vetveten, por ai e quan qyteti N në një mënyrë krejt jashtë shijes në modë, diçka sa reale, sa sureale, sa anonim, sa shumësi përbërësish, po të kemi parasysh se N-ja vjen edhe në idenë e n-qyteteve, d.m.th. shumësisë, së tërës sonë si qytet-qytetërim po që për paradoks kërkon të mbahet peng i një diçkaje absurde, jashtë shijes dhe origjinës së tij.

Kështu Kadare nga një status universal, në konceptimin artistik, me elokuencë e përjetim i drejtohet simbolikës kontekstuale, pavarësisht se simbolika tradicionale e “kështjellave”, “kullave”, “dragonjve”, “luanëve” etj., së bashku me alegorizmin dhe psikologjizmin e personazheve, me mbizotërim të monologut të brendshëm, ishin aq fort për zemër për autorët soçrealistë dhe kalorësit feudalë të kritikës.

Dhe ky qytet N, (ku çdo vit përmes një dekori dhe pate-tike folklorike, në gjendje ekstaze, poetë të llojit “Ramiz Beqiri”, mitit të gjallë të shqiptarëve, do t’i thurnin diti-rambe sui-generis (“A ka këngë/që e këndon këtë burrë/ pikërisht në muajin e letërsisë”), i lexuar në kodin e simbolikës si shasi e gjithë veprës, tingëllon më tepër se nudo-lakuriq, i braktisur vlerave të veta qytetëruese, “edhe pse ndoshta ishte i vetmi qytet në botë ku kalim-tari duke ecur rrugës për një hap të gabuar do të rrokulisej e të thyente kokën mbi çatinë e një shtëpie tjetër”, pohon autori. Kodi metonimik dhe nënteksti kadarejan shpalosen madhështorë: Arkitektura e këtij qyteti për të cilin tregoheshin aq anekdota, si një nga qytetet më të shëmtuar të Shqipërisë, me befasinë kompozicionale dhe vlerat shpirtërore, magjepsje, që struk në gjirin e saj, vjen si tingëllimë e qartë e një tradite dhe qytetërimi të shkëlqyer, që i ka rezistuar kohës në origjinalitetin e tij, por që çuditërisht nën trysinë e një eksperimenti, qe kthyer në qytet N (nul...), që i trembej “zving-zvingut” të origjinës së tij. Kujtojmë këtu tipin e qytetarit Qull Qani, apo Qani Qulli, modelin e ish-drejtorit njeri, apo të njeriut ish-drejtor të 1910-tës, i cili kurrë nuk ulej prej tribunave në tubimet zyrtare.

Në gjithë sfondin e romanit po aq, sa nuk shohim “luftëtarë të vijës së parë”, “flamurtarë aksionesh”, “një tonin” e “një të armikut”, “komisarë të dritës”, “pionierë vigjilentë”, po aq nuk shohim “ditë me diell”, “netë me hënë”, “qytete të lulëzuara”, “natyrë të qeshur”, “fytyra gazmore”, por madje dekor të zymtë, ndjenja skepticizmi maksimal, ditë me shi nga fillimi deri në epilog, personazhe parazitë si “heronjtë” kryesorë (Gjonin, Mentorin e Evgjenin), që autori “harron” t’i përmendë qoftë edhe një rast si të “vijës së parë” ku duhet të shkëlqente “filli i kuq” si “garanci” e së ardhmes...

Në të njëjtin sfond autori jep një grup vajzash moral-grisura si Roza Papa, Luiza Angoni, Lizheta Konomi, Eratulla Kristaqi që pëlqejnë seksin kolektiv dhe abortet me “shumicë”, sikur Diana Mezini, që pëlqente seksin “herë me njërin, herë me tjetrin”. Më tepër se realitet shpirtëror modern, hapësinor, në atë qytet të lashtë (të cilin Kadare do ta donte artistikisht si i madhi Balzak Parisin, përmes përjetimeve artistike të të gjitha skutave të frymëmarrjes së tij), këto raporte mes çiftesh vijnë si sfidë ndaj atyre shtampave në oazin e një përpjekjeje groteske të moralit “të sugjeruar”; herë si moral borgjez, herë si moral komunist, herë si moral proletar, herë si moral klasor, herë... si fasadë e një filozofie që në vend të së vërtetës mbi domethënien etiko-qytetare të qenies njerëzore, ofronte realisht shtjetërsimin e saj, të jetuarit në oazin e hipokrizisë civile.

Këto ndërhyrje në jetën e tjetrit po bëheshin aq të padurueshme, sa që njeriu “nuk mund t’i mirrte lejen, as t’i shfaqte vullnetin e zemrës së vet” vetvetes, nëse

nuk donte zemra e vullneti i “nënës parti”. Lotët e kësaj të fundit mund të ktheheshin në lotë gjaku, lotë dhimbje e përhershme për poetë si “haramziu” që trazonte, më saktë thumbonte herëpashere me shkrimet e tij Lame Qorrët, Jorgo Senicët, Kethët, apo Ramiz Bilbilët e qytetit N.

Dhe kur thumbi helmues kërkonte të hidhte “helmin e vet” në venat e Lame Qorrit, që sot mund ta gjeje të frymëzuar si Çajld Harold, nesër të dëshpëruar si Peçorin, në emër të “vigjilencës revolucionare”, këtu “durimi s’bënte më, bile mund të impononte edhe “saktërisht” të tilla etiko-estetiko-filozofike, sa “Çajupin nga përcaktimi i tij si poet demokrat revolucionar me tendencë anti-fashiste, “duhej” ta kthenim (në rrugën e së ardhmes sonë pas vdekjes), si poet revolucionar demokrat me tendencë antiimperialiste “ku duken (qartë) simptomat e luftës së klasave”. Kështu që poetit “haramzi” të N-ës, shpeshherë, i kujtohej me respekt këshilla e një kolegu të universitetit:

“Kur je në çaste pasigurie dhe s’ke guxim kujto o i mjerë, që pas ca vjetësh që do të bëhesh pluhur e kocka, do të kesh një kryq mbi kokë dhe pastaj asgjë më, hiç pambarim...”

Kishte të drejtë Evgjeni kur thoshte: “Edhe yjet ushqehen me shpirtëra”. Madje Gjoni, si strumbullari, “koka” (kokë në fakt që nuk i del aq punë me “kokat “ tjera) e vetme “linjë” subjekti, ku ndryshe traditës realiste mungojnë pikëlidhja, linjat e veprimit si konfrontim, kulmorja, zgjidhja finale e lumtur “së jashtëmi”), nuk jepet në asnjë çast i preokupuar si “komisar i dritës”. Çuditërisht ai ka një tjetër preokupim absurd në oazin e ekstazës revolucionare “Ju të rinj, ju të reja, i madh është vrulli jonë”, “një nga ëndrrat e para (kur u bë përsëri i aftë të ëndërrojë), ishte dita kur do të lamtumirësohej me N-ën...”, shprehet autori. Në dhomën e Gjonit nuk shohim portretin e udhëheqësit “tonë”, përkundrazi, bri portretit të Sami Frashërit, ai ka vendosur atë të Xhina Lolobrixhidës nudo.

Dhe, kur në gojën e Mentorit mund të dëgjonim emrin e ndonjë “kështjelle”, “shtegu partizan”, “kalaje”, “transformimi madhështor” (jo se edhe nuk pati edhe ndërmarrje me karakter thellësisht demokratik si Reforma Arsimore, Reforma Agrare apo në Shëndetësi) mësojmë prej tij për një ish-shtëpi publike, në zemër të N-së, në 44-tën nën “ekstazën” e prostitucionit të së cilës “gjithë kalamajtë e N-së mësuan onanizmin”, rënien me dorë....

Dhe në akord të plotë me këtë “atmosferë epsi”, kur ajo revolucionare: “Hajt të shkojmë / djersën të kullojmë, / se ndërtojmë / Shqipërinë e re /”, ishte normë mitmorale revolucionar, deri në tmerr, ai shqetësohej për sfilizin që kishte “fituar” gjatë kontakteve seksuale.

Kur pritët nga Gjoni “bëma” kulmore, zgjidhja, lexuesi njihet me “makromekanismin” absurd, po aq grotesk, përpjekjen “për të çarë” në jetë: Krijimin e pergamenëve të rremë. Mesazhi dhe nënteksti kushtrimojnë fort: Çmenduria e revizionimit të gjithçkaje, nën ethet e dogmës, si instrument i mbajtjes së përrjetshme të pushtetit vetiak po përfshinte tërë panteonin e vlerave tona si qytetërim. Kështu, nëse Naimi, Mjeda, Çajupi, Serembe, Asdreni, Migjeni, Noli, etj., do të “reformoheshin” përmes interpretimit, nën dritën e boshtit ideologjik, Fisha, Konica, Kuteli, Camaj, Pipa, Koliqi etj., do të braktiseshin si agjentë të austriakëve, italianëve, i drejtë e i të birit, ndërkohë që Lasgushi, gjenerali i poezisë, në vetminë e tij brilante, me heshtjen rebeluese do t’i kthehej deri dashurisë së vonë, tamam si Gëte i madh për të ruajtur të shenjtë “kështjellën” e tij, muzën e artistit të vërtetë.

Kur falsifikohet rëndshëm në panteonin e kulturës së një populli, ç’fund i lumtur do të ishte për fatin e heroit tonë? Këto gjetje artistike, jashtëzakonisht të spikatura, vinë plot domethënie estetiko-filozofike nën “push-

tetin" e një grotesku dhe nënteksti tepër të fuqishëm, kur gjithçka mund të "rishikohej", "revolucionarizohej" edhe pas vdekjes nën idenë groteske dhe absurde të një euforie dilerante: "Nuk ka kala që nuk marrin komunistët". Madje mund të shkohej deri atje aq, sa të "duhej" të sakrifikohej edhe gjaku i nënës apo i babës në emër të "nënës" Parti, pa le sa punë e thjeshtë ishin "biografite", "kontributet njerëzore", "lëvizjet pa progres" nën ekstazën e "kauzës sonë të përbashkët". Në këto rrethana Kadare nuk "kënaqet" ta quaj ndryshe qytetin N, vetëm qytet pa reklama, si Nulqytet, jashtë çdo paraqitjeje të shtirur, si të thuash "të porositur", apo të "këshilluar", çka qe aq për gusto në letërsinë shqipe të asaj stine plot shkëlqim të rremë. "Në vetëdijen e tij Gjoni i quante vitet që do të kalonte në N, si vite të fshira nga jeta e tij", pohon autori.

Autori, aspak i prirur drejt përshkrimit entuziast, madje këtë gjë e ka frikë si vdekjen, pohon: "Ai do ta braktiste patjetër N, sepse, nëse nuk do ta braktiste, ai do të vdiste", duke operuar kështu suksesshëm në thelbin e qenies, në natyrshmërinë, jashtë çdo shije "së jashtmi" që mund t'i imponohej njeriut, definon idenë e vet autori, falë një meditacioni të fuqishëm që ridimensionon hapësirën poetike të frymëmarrjes së romanit.

Ky është altruizmi i llojit "Një për të gjithë e të gjithë për një" në këtë vepër të Kadaresë duke na tërhequr kështu drejt mesazhit thelbësor: "Shkatërimi më i madh që mund t'i bëhej një qytetërimi është shkatërimi i vlerave shpirtërore të tij". Ja si shprehet ai përmes narratorit: "Unë jam me... Qimo Papët, Lame Qorrët, Kethët etj. Unë jam mizerje. Po pse jam mizerje? Unë jam karrierist. Unë dua kryeqytetin, s'heq dorë nga kryeqyteti".

Kështu, përmes ekspresionesh aq të shpeshta, që vinë si përplasje "së brendëshmi" me vektorin e tretë si kryefjalë Ai-Ajo, autori krijon tablo meditative dhe ren-

ditje asosacionale, të cilat "injorojnë" fare "destinacionin tradicional" - rrjedhën horizontale të ngjarjeve, në formën e një lëvizjeje të fuqishme të mendimit, po aq në formën e enumeracioneve epitetike. "Me të vërtetë ai ishte aq i poshtë, aq i poshtë, aq i poshtë, i poshtë, i poshtë, sikur në formën e një shkallëzimi ngjites". "Ajo deshi ta shante, ta pështynte, ta gërricte me thonj", apo në formën e një dileme të çuditshme: "Ajo nuk do t'i kërkonte kurrë para atij... Ajo duhej t'ia kërkonte atij", po kaq në një formë fantazmagorike: "klasa i ngjante si një përbindësh me dyzet palë sy që e shikonin plot djallëzi" - meditacion që vinte aq paradoksal në atmosferën aq revolucionare, vërtet të admirueshme, të zbatimit të disa reformave me karakter demokratik, popullor të shumëpritura. Marrëdhëniet me gjimnazisten Stela, ku thyhet miti zyrtar, janë dhënë plot sentiment dhe kolorit poetik, një gjerdan elegant renditjesh asosacionale, ku ndjehet në thellësi të qenies, të personazhit tonë, një "brejtje" në "turbullirën e shpirtit", të cilën autori e pranon vetëm si të shenjtë dhe të paprekshme, ndryshe si një vrasje ndërgjegjeje qetësihumbëse, si një masakrim moral e shpirtëror të vetvetes. "Po pse jam mizerje... Mizerje, mizerje me bisht" - kushttrimon autori kundër mediokritetit letrar. Duke e ndërjerë letërsinë, nën këtë trysni, si një mallkim, ai shprehet:

"Unë të dua Stela. Asgjë s'më gëzon. As pasuria, as transferimi, as fama. Sepse të dua ty, Stela", shpërthen me shkrim poetik brilant autori.

E, ndonëse Stela, një mrekulli në virgjërinë e saj shpirtërore, me një botë plot ndjenja në idealitetin e saj po aq mrekullor e të pafajshëm: "ajo u dha e tëra pas përkëdheljeve me nerva të shkrehura, siç ish, për herë të parë në jetë dhe pa asnjë kundërshtim iu dorëzua e gjitha" do ta ndjente e mbronte me gjithçka të kërkonte momenti dashurinë e saj., Gjoni detyrohet të ndahet nga Stela, përballë hyjnisë shpirtërore të saj, sepse au-

zeze (ujë i vluar, naftë e material të tjera). Mbi të gjitha termeti ishte një tragjedi me shumë viktime, dhimbje, lotë dhe vuajtje njerëzore. U vranë 35 persona dhe u plagosen 382 të tjerë. Në Dajç, në një familje vdiqën pesë veta.

Për përbindëshin e situatës u ngrit Shtabi Qendror i Republikës dhe shtabet e rretheve. Gjithashtu u mobilizuan me mijëra forca nga ushtria, rendi dhe vullnetare për tu gjendur sa më pranë në ndihmë të njerëzve në nevojë. Familjeve pa strehë iu dhanë çadra, batanija, ushqime, veshmbathje etj. Motoja e ditës: "Të shpëtojme sa më shumë jetë njerëzore". "Të gjithë për një dhe një për të gjithë."

Edhe Drejtoria PTT Shkodër u godit rendë nga tërmeti. Ai shkatërroi pjesën më të madhe të linjave dhe godinave, veçanërisht në zonën e NënShkodrës e më gjërë. Intensiteti i lartë i punimeve për eliminimin në kohë rekord, pesë muaj, të pasojave të termetit apokaliptik kërkonte mobilizimin total, investime suplementare, rritjen e mëtejshme të sasisë e cilësisë së shërbimeve postare, telefonike e telegrafike; sepse njerëzit e aksionit që ishin me mijëra kishin nevojë urgjente të komunikimit çdo ditë me familjen dhe të afërmit e tyre. Si Kryetar i Degës së Finances i asaj përiudhe të lavdishme, e cila nuk mund dhe s'duhej të harrohet kurrë, falenderoj nga zemra përsëri edhe tani pas 37 viteve të gjithë punonjësit e PTT Shkodër, teknikët e fillrojtësit, të cilët punuan ditë e natë me përkushtim e sakrificë për zbatimin në mënyrë korekte të detyrave të ngarkuara.

Filluan të "lulëzojnë" një nga një për tu bërë shumë si lulet që çelin në pranverë shtëpitë e reja, të cilat u dhanë falas të gjithëve pa përjashtim nga shteti. Në këtë kuadër u rindërtua plotësisht nga themelet lagjja e vjetër e Bohçallekut, e cila krahas bujarisë e fisnikërisë së banorëve të saj është e njohur edhe për kopshtet plot me pemë frutore. Një qytet i vogël modern me vila dykatëshe shkëlqente si margaritar, sidomos natën, në hyrje të qytetit.

Termetët kanë origjinë, forcë shkatërruese e karakteristika të veçanta në krahina e zona të ndryshme të planetit. Ata u përkasin atyreve fenomenëve madhore, të cilët megjithëse kanë një "regullator", veprojnë jashtë dëshirës, vullnetit e kontrollit të çdo force tjetër.

tori për herë të parë në vetvete do të ndjente ftohjen me muzën e tij, ndofta për t'iu rikthyer më me pasion dhe pashmangshmërisht "mushkës xanxare", tashmë nën hijen e askujt, veç "hijeve shekspiriane" plot jetë. Në vështrimin kompozicional, në vështrim të motivit dhe mesazhit estetiko-filozofik gjithë kjo vinte si një përpjekje e autorit kundër atij vizioni socrealist, i zhveshur totalisht nga misteri i fjalës "mister", "sonete vetëm pas një nate ai vetë u bë si ata: "indigjen" i mbështjellë me misterin e provincës", shprehet autori duke u përpjekur kështu të depërtojë në metafizikën e karakterit.

Duke ndërtuar gjithë "bëmat" e karaktereve në një linjë të vetme në roman ku personazhet dytësore plotësojnë komponentet artistike të shprehjes së tyre, por kurrë në rrafshin e një ndeshjeje, përballimi frontal-përbashkës linjash, po aq sa realizon artistikisht karakteret në kufinj të një fabule të reduktuar, me alternim asosacionesh, si një konceptim antipod i linjës horizontale-tradicionale Kadare, jo thjesht, dëshmon me një theks jashtëzakonisht aktual se, kurrsesi, fabula, as mungesa e saj nuk mund të jenë kusht, patjetër, i domosdoshëm i modernitetit të një vepre letrare. Me shumë domethënie vjen edhe epilogu i romanit: Evgjani Peri, që fillimisht e refuzoi "falsifikimin e historisë së kombit të tij", mban në dorë një zarf adresuar presidentit të Akademisë së Shkencave të RP të Shqipërisë, në një mëdyshje për ta dorëzuar në postë në pahunë e një shiut të imët ku thëllimi që fryn lëkund çdo gjë: dritat, siluetat, drurët. Ndoshta ky thëllim si shpresë e së nesërme se jo çdo gjë do të tretej nën trysinë e modelit të ri, socrealizmit që me të drejtë Trebeshina e pati cilësuar si realizmi me bisht, thënë ndryshe mohënie e realizmit të vërtetë.

Kadri Ujkaj, kritik letrar
Shkodër, më 1 mars 2016

NJË PËRBINDESH U ZGJUA NGA GJUMI

Ishte një mëngjes i bukur pranveror. Ai erdhi, në rrjedhjen e vet të pambarim të kohës, dita plot diell e shkelqim e 15 Prillit 1979. Ishte e Diela e Pashkëve... Rreth orës 6 e 45 minuta u nisa me biçikletë nga shtëpia në ndërmarrje për nxjerrjen e bilancit të tremujorit të parë 1979. Në momentin fatal, ora 7 e 19 minuta, kur po shkruaja fjalët: "Për stornim artikulli nr.....", të cilat nuk arrita ti hedhja në ditar, sepse një goditje tepër e fuqishme më hodhi me forcë nga zyra e finances e katit të dytë drejtë shkallëve poshtë dhe përjashta!

Termeti me magnitudë 7.2 dhe intensitet në epiqendër 9 ballë e gjysëm goditjen më të fuqishme e dha në detin Adriatik, në afërsi të qytetit Petrovac (Mali i Zi). Pas disa minutave u dëgjuan burijet trishtuese të makinave të ndihmës së shpejtë, të cilat lëviznin me shpejtësi "rrufe" nga Zona e Nën Shkodrës drejt Spitalit Rajonal të qytetit. Rreth ores 11-të paradreke u thirrë një mbledhje e jashtzakonshme e të gjitha strukturave drejtuese të rrethit për përbindëshin e kësaj fatkeqësie të madhe.

E tërë Shqipëria dhe Bota u njohën me përmasat e termetit katastrofik tetë ballësh i shkallës Rihter i 15 Prillit 1979. Ishin ç'vendosur formacione kolosale të shtresave nëntokësore, që ndodhën disa dhjetëra km në thellësitë e Tokës, të cilat fokusin e goditjeve fatale e paten në një zonë të gjerë të detit Adriatik, nga Shëngjini- Velipojë-Dajç-Ulqin e më tej. Rreth perimetrin të epiqendrës së tërmetit pati shkatërime drithëruese. U dëmtuan 17122 shtëpi banimi dhe objekte social-kulturore. Në rrethet e Shkodrës e Lezhës totali i përgjithshëm arriti në 14686 ndërtesa, prej të cilave 2413 u shkatërruan plotësisht. Mbi 100 mijë banorë mbeten pa strehë.

Termeti solli shkatërime të mëdha, sepse tronditjet e tokës ishin apokaliptike. Në Dajç e Velipojë Dielli u "mbulua" nga pluhuri, degët dhe gjethët e pemëve si edhe nga gurët e madhësive të ndryshme, që zbriten furishëm nga malet e kodrat përrreth. Në disa vende u çapa toka dhe mbi sipërfaqe doli një përzierje me ngjyrë të

Njerëzimi, me zhvillimin e mëtejshëm të Shkencës e Teknikës, po futët gjithnjë e më thellë në zbulimin e "mekanizmit misterioz" të termetëve duke krijuar mjete dhe paisje çdo herë e më moderne për "parashikimin" sa më të saktë të kohës e forcës goditëse të tyre. Planifikimi i "masave parandaluese", veçanërisht projektimi e ndërtimi i të gjitha godinave më cilësi, bazamente e konstruksione të studiuara e solide është përgjegjësi sëpari e Shtetit, e specialistëve dhe e çdo qytetari. Çdo nënvlerësim, anashkalim, indiferentizem, shkelje ose abuzim do të kishte pasojë fatale për vendin, njerëzit e shoqërinë.

O burra kush është trim

-Kushtuar Termetit katastrofik të 15 Prillit 1979-

Me Diell plot shkelqim agoi dita
Përbindshin e Nëntokës e zuri termbimi
U tunden male e kodra, "Rrozullimi"
Në Shkodër e Lezhë erdhi shkatërimi!

Në mes të germadhëve dikush thirri:
O Zot! U përmbys Bota! Kuku, ç'na gjeti!
Dhe një tjetër: Erdhi dita e Kiametit!
Nën këmbët tona po çahet toka!

Me rrobat e natës, me vrap të shpëtojnë
Përjashta në oborre, kopshte e trotuare
Burra, gra me fëmijë, pleq e plaka shpejtojnë
Makinat e ndihmës së shpejtë sinjalizojnë vaje!

Shqipëria si repart ushtarak u ngrit në këmbë:
"Të rindërtojmë me çdo çmim vendin
Njerëzit në asnjë rrethanë nuk do ti lajmë
Pa strehë, në mes skamjes, urisë e territ"

E Dielë, Ringjallja e Jezusit, festa e Pashkëve
Urdhër nga Lartë: "Të gjithë në aksion
Puna vullnetare, leitmotiv i proletarëve
Jemi në rrethim, o burra kush është trim!"

Luigj Temali, Shkodër, më 15 prill 2016

NË KUPË MË SHUMË NË FUTBOLLIN SHKODRANË

Në muajin mars të këtij viti, nga data 24 deri me 29, shoqata "The door" Albania, dega Shkodër, zhvilloi një veprimtari sportive me ekipet e futbollit të moshës 11 dhe 13 vjeç në Rovereto në Itali, nën drejtimin e tarinerit të ri dhe të përkushtuar, Elton Bungaja.

Në këtë veprimtari morën pjesë nëzetegjashtë vende të ndryshme nga Europa, dhe Azia, si nga Gjermania, Italia, Holanda, Franca, Spanja, Zvicra, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kina, Japonia, etj.

Stërvitja intensive e ekipit tonë, përkushtimi dhe pasioni i fëmijëve, stafit teknik, edukimi psiko-fizik, bënë të mundur fitoren e këtij kampionati dhe duke sjell me krenari kupën në qytetin e tyre, në Shkodër.

Në formacion kishte edhe talente të reja nga zona e Dukagjint dhe zonavës së Rrethinave të Shkodrës, të cilët premtajn shumë për të ardhmen e futbollit në Shkodër dhe më gjerë.

Në këtë vprimtari u dalluan për moshën 13 vjeçare Kristian Nika, Daniel



Kodra, Kevin Patogu, Erion Zefi, Samuel Doçi, Mirsad Zani, Endi Cufi, Xhovan Livadhi, Ardit Nika, etj. Ndërsa në ekipin e 11 vjeçarëve u dalluan Amin Tahiri, Aron Jakaj, Arti Bisha, Enio Çoçja, etj.

Në ceremoninë e mbydhjes, ekipi ynë me meritë zuri vendin e parë, duke

përcjellë emocione të forta, teksa edhe një herë valvitej Flamuri Ynë Kombëtar në podiumin e nderit në Rovereto. Marrje e kupës në duar e njoma të bijëve tonë nën drejtimin e traninerit të guximshëm dhe të talentuar, dalit të Dukagjinit Elton Bungaja, jehoi si një këmbanë shprese për të



ardhmen e futbollit tonë dhe vlerave që përçon edhe krahina e Dukagjinit.

Qyteti Shkodrës u rezervoj një pritje shumë të ngrohtë dhe mirënjohëse djemëve tonë dhe suksesin e meritur të tyre.

Zef Lulashi

KRUJA DHE LEZHA, DY QENDRAT VENDIMTARE TË HISTORISË

Pse i mora këto dy qendra, këto dy pika të orientimit tonë, të mesazhit tonë, të vizionit tonë dhe të vlerës së pavdekshme që kanë? Ka shumë arsye e njëra ndër këto është se pikërisht këto dy qendra janë ndër vendet më të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar europian.

Kruja, duke qenë një metropol dhe një qytet i lashtë i Arbnisë dhe ilirëve, ka qenë gjithmonë zemra e heroizmit, shtylla dhe vendi më me peshë në historinë e mesjetës respektivisht në epokën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Kruja ka bartur peshën e tërë diplomacisë europiane të kohës së mesjetës, sepse me rikthimin e Gjergj Kastriotit tanimë sytë e tërë popujve të Europës ishin kthyer nga Kruja, nga lideri, strategu dhe vizionari i saj, i cili u bë mburojë e civilizimit të përbashkët të familjes europiane.

Kruja është vendi ku u mbrojt qenia arbnore nga hordhitë osmane. Kruja është pika e referimit dhe monument i lirisë, pavarësisë dhe i rikthimit të dinjitetit arbnor e europian. Aty nuk është mbrojtur vetëm qenia jonë arbnore,

identiteti e kultura. Aty është mbrojtur e tërë Europa, sepse Kruja në krye me Gjergj Kastriotin u bë mur i pakalueshëm për pushtuesin barbar osman.

Vlera historike, monumentale dhe heroike që ka Kruja nuk ka vend në botë që mund të krahasohet për nga qëndresa, për nga arsyeja se ishte pikërisht ky vend, ky metropol në atë kohë i cili kishte marrën epitetin e metropolit të Aleksandrit të dytë, e metropolit të Vizionarit, e metropolit të Atletit të Krishtit, e metropolit të Strategut dhe liderit të papërsëritshëm Gjergj Kastriotit. Prandaj, Gjergj Kastrioti Skënderbeu në luftën e tij heroike tridhjetë vjeçare nga kështjella e tij Kruja u bë një nga emrat e shqiptarëve më të njohur në të gjithë Europën. "(H. Gelzer, B. G. Teubner, 1904 faqe 184).

Thjeshtë në atë kohë Kruja ishte kryeqendra e heroizmit, e sakrificës, e diplomacisë dhe e mbrojtjes së shtëpisë së përbashkët të Europës si kontinent. Por kjo vetëm nga një njeri, vetëm nga një Aleksandër i dytë siç ishte Gjergj Kastrioti, pas vdekjes së tij Europa kishte mbetur pa kryeqendrën e saj, pa strategun, pa vizionarin. Europa thjeshtë kishte mbetur pa mbrojtësin e saj dhe në rrezik të humbjes së vlerave të përbashkëta që kishte. Por edhe pas vdekjes së rishit Shqipëria u bë ndalesë e dytë e osmanëve barbarë, sepse aty u ndal, aty bëri fushën e saj të marrëzive, të gjenocidit, të zhvlerësimit të Shqipërisë nga një Shqipëri e Kastriotit dhe europiane në një Shqipëri osmane.

Në Shqipëri, pushtuesi barbar osman e shfryu urrejtjen e saj ndaj këtij kombi të lashtë, ajo aty përdhosi dhe ndaloi të gjitha çfarë përfaqësonte ky komb dhe duke e divorcuar atë për shekuj nga Europa, nga familja e saj e natyrshme.

Ndërsa Lezha, po ashtu është një qytet i lashtë, vend ku janë shenjtëruar themel e bashkimit të fiseve dhe kombit, vend i marrjes së përgjegjësisë historike dhe fatit të vendit duke lidhur besën me njëri tjetrin dhe duke vendosur në krye të urtin dhe vizionarin Gjergj Kastrioti. Ky vend i vlerave të pavdekshme të kombit tonë përbën arsyen e madhe të kohës në të cilën fati i kombit arbnor ishte i madh se kishte arritur që të unifikonte trupin e tij dhe të realizonte aspiratat e tij historike në luftën për liri kundër pushtuesit barbar osman. Por kjo nuk do të mund të arrihej pa seriozitetin e madh të Gjergj Kastriotit dhe fisnorëve tjerë, dhe siç dihet serioziteti është themeli i të gjithë prosperitetit të një shoqërie, individi, kombi e të tjerë. Lezha ka marrë karakterin historik të veçantë sidomos më Kuvendin e Lezhës së 2 Mars 1444, por duhet ditur se Lezha ka një histori edhe më të lashtë, është qendra e vrojtimit të Shqipërisë dhe jo rastësisht Gjergji ka zgjedhur këtë vend për themelimin e Kuvendit të Lezhës. Po ashtu, Gjergj Kastrioti vdiq aty ku edhe i bashkoi forcat dhe unifikoi kombin. Kështu që Lezha është e rëndësishme së madhe historike sepse ka dy monumente atë të Kuvendit në Katedralen e Shën Nikollës,

dhe vendin e vdekjes së Gjergj Kastriotit, tek këto dy vende shqiptarët e vërtetë do të duhej gjithmonë të përkulën dhe të frymëzohen e marrin frymën e unitetit, e pavdekësisë dhe seriozitetit të Gjergj Kastriotit dhe porositi e tij.

Shqiptarët sot mund t'i rikthehen rrugës së Gjergj Kastriotit vetëm pasi të kuptojnë drejt luftën që ai bëri kundër pushtuesit barbar osman dhe ideologjisë së saj që la në trojet shqiptare. Gjergj Kastrioti nuk lejoi që ideologjia e pushtuesit osman të zë rrënjë tek arbnorët sa ai ishte gjallë, madje ai nuk la asnjë gjurmë të pushtuesit në trojet arbnore, sepse ai donte një Shqipëri të pastër dhe europiane. Me pak fjalë këto dy monumente, këto dy vende të paçmueshme kombëtare flasin më tepër se të gjitha monumentet e mermerit dhe bronzit, aty janë burimet e përjetshme dhe mbeten si vendet ku kishte strategji, diplomaci, politikë të gjithanshme dhe unifikuese si dhe të frytshme dhe këto janë e do të jenë për të gjithë brezat e ardhshëm. Prandaj edhe sot sado që nuk janë punët mirë dhe si Kosova edhe Shqipëria nuk janë duke ecur rrugës dhe vizionit të Gjergj Kastriotit, ato nuk mund t'i rezistojnë diellit, i cili na ndriçon të gjithë ne, e cila zgjon të gjitha qeniet arbnore në jetë dhe përshkruan atyre rrugën që ata duhet të ecin në dritën e etërve tanë të lashtë dhe mbi të gjitha në udhën e Gjergj Kastriotit, udhë kjo e rikthimit tek rrënjët tona, e rikthimit të Shqipërisë në familjen europiane.

Nga Gjon KEKA

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

VATË MUSA

Dashmirës i Shoqatës Atdhetare Dukagjini, Shkodër